

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5477
E mërkurë, 16 maj 2018
çmimi 0.40 €

Myftiu Tërnavë uron
besimtarët myslimanë
për muajin e Ramazanit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

FAJONI: KOSOVA KA PËRMBUSHUR KUSHTET E FUNDIT PËR VIZAT F. 2

GJASHTË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DUHET TË ANËTARËSOHEN NJËKOHËSISHT NË BE F. 7

BE-ja: KOSOVA PO BËN REFORMA PËRMBAJTJESORE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE F. 6


EKONOMI

KOSOVA PËRFITON 5.4 MILIONË EURO PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE F. 9

VALA SJELL PAKO TË REJA POSTPAID F. 8

KULTURË

JAKOV XOKA, KRIJUES I MADH I LETËRSISË SHQIPE F. 16



REXHEP QOSJA

SPORT

PRISHTINA - DRITA NUK ZHVILLOHET NË KRYEQYTET. AKUZOHE DHE KËRCËNOHET VOKRRI F. 18

MË 29 MAJ MIQËSORJA SHQIPËRI - KOSOVË F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", MAHIR JAGXHILLAR

FAQE 4-5

Reformimi i administratës publike, proces i pandalshëm

- Ligji për Pagat do të procedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës gjatë muajit qershor



Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se janë duke punuar për krijimin e një administrate publike moderne, të qëndrueshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe të bizneseve. Ai ka treguar se aktualisht

MAP-i është në fazën finale të rishikimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jagxhillari ka deklaruar se reformimi i administratës publike do të jetë proces i

pandalshëm. Ministri Jagxhillar ka paralajmëruar se gjatë muajit qershor do të dërgohen për miratim në Qeveri tri ligjet bazike të administratës publike: Ligji për Pagat, Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për Organizimin e Administratës Publike

Clarku: Prioritet për Kosovën, zhvillimi ekonomik, pastaj ushtria

Ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s në Evropë, Wesley K. Clark, ka thënë të martën në Prishtinë se institucionet e Kosovës duhet ta kenë prioritet zhvillimin ekonomik para çështjes së formimit të ushtrisë. Në një konferencë me gazetarë të mbajtur në Universitetin Amerikan në kryeqytet, ai ka thënë se shpenzimet për ushtrinë mund të ndikojnë në çrregullimin e zhvillimit dhe të ardhmes ekonomike të vendit. Duke folur rreth dialogut Kosovë - Serbi, gjenerali amerikan ka thënë se pret një marrëveshje të normalizimit të raporteve mes dy shteteve

FAQE 2



Haradinaj paralajmëron se ushtria do të bëhet edhe me ligj

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Clarku: Prioritet për Kosovën, zhvillimi ekonomik, pastaj ushtria

Ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s në Evropë, Wesley K. Clark, ka thënë të martën në Prishtinë se institucionet e Kosovës duhet ta kenë prioritet zhvillimin ekonomik para çështjes së formimit të ushtrisë. Në një konferencë me gazetarë të mbajtur në Universitetin Amerikan në kryeqytet, ai ka thënë se shpenzimet për ushtrinë mund të ndikojnë në çrregullimin e zhvillimit dhe të ardhmes ekonomike të vendit. Duke folur rreth dialogut Kosovë - Serbi, gjenerali amerikan ka thënë se pret një marrëveshje të normalizimit të raporteve mes dy shteteve

**EPOKA
ERE****Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 15 MAJ - Ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s në Evropë, Wesley K. Clark, ka thënë se zhvillimi ekonomik është më se i rëndësishëm për të dëshmuar te të tjerët se Kosova është shtet demokratik. Në një konferencë me gazetarë të mbajtur në Universitetin Amerikan në Prishtinë, gjenerali në pension, i cili udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe gjatë vitit 1999, ka thënë se zhvillimi ekonomik duhet të jetë prioritet para çështjes së formimit të ushtrisë. "Po të isha unë në Kosovë do të llogarisja në mbrojtjen e KFOR-it dhe të NATO-s dhe më me dëshirë do t'i shihja burimet e Qeverisë të shpenzohen për zhvillimin ekonomik sesa për forcat ushtarake", ka deklaruar gjenerali amerikan. Sipas tij, rregulla bazë në ushtri është se duhet të kesh aq forca ushtarake sa ka nevojë për mbrojtjen, sigurinë e vendit dhe jo më shumë. Clarku ua ka rikujtuar institucioneve të Kosovës, të cilat e kanë vënë si prioritet themelimin e Forcave Ushtarake të Kosovës, se shpenzimet për ushtrinë mund të ndikojnë në çrregullimin e zhvillimit dhe të ardhmes ekonomike të vendit. "Mënyra më e mirë për të siguruar të ardhmen e Kosovës së pavarur e demokratike është

zhvillimi ekonomik", ka theksuar ai, duke shtuar se KFOR-i duhet të qëndrojë ende në Kosovë. "Mendoj se do të vijë koha për KFOR-in që të largohet. Por, mendimi im personal është se kjo nuk është koha e duhur që KFOR-i të largohet", është shprehur Clark. Ai ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi për normalizim të marrëdhënieve. "Ajo që unë dua ta shoh është arritja e një marrëveshjeje midis Serbisë dhe Kosovës e cila do t'i normalizonte marrëdhëniet mes tyre. Le

ta ketë Kosova ulësen e saj në Kombet e Bashkuara dhe, eventualisht, bashkë me Serbinë, të dyja të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Nuk ka

arsye pse dy shtetet nuk mund të jenë fqinjë të mirë", ka deklaruar Clarku. Ndër të tjera, ai ka treguar se do të dëshironte ta shihte Kosovën pjesë të Bashkimit

Evropian ku rinia do të qëndronte dhe punonte në Kosovë, pa pasur nevojë të kërkojë jetë më të mirë nëpër vendet evropiane.

Kosova përjetë mirënjohëse për ndihmën e gjeneralit amerikan Wesley Clark

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - "Kosova dhe populli i saj do t'i jenë përjetë mirënjohës dhe asnjëherë nuk do ta harrojnë ndihmën e gjeneralit amerikan, Wesley Clark dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Emri i tij do të jetë përherë në kujtesën e shqiptarëve kudo që jetojnë ata", kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë takimit me ish-komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjeneralin Wesley Clark, i cili po qëndron për vizitë në Kosovë. Kryeministri Haradinaj vlerësoi lart kontributin e gjeneralit Clark gjatë viteve 1999, nën komandën e të cilit filluan intervenimet e



NATO-s mbi caqet serbe, për të shpëtuar një popull të tërë shqiptar të pambrojtur, ndaj të cilit ushtrohej gjenocid. "Falë ndihmës së Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, NATO-s, presidentit Bill Clinton, sekretares Madeleine Albright, gjeneralit Wesley Clark, ish-kryeministrit britanik Tony Blair dhe gjithë

botës demokratike që kontribuoi për lirinë e saj, Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. Përjetë mirënjohës gjithë atyre që shpëtuan nga shfarosja popullin tonë", tha kryeministri Haradinaj. Kryeministri Haradinaj gjatë takimit shprehu gatishtësinë e Qeverisë së Kosovës për t'i mbështetur fondacionet amerikane që u dedikohen programeve arsimore. Ish-komandanti suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjenerali amerikan Wesley Clark, falënderoi kryeministrin Haradinaj për pritje, duke theksuar se Kosova dhe populli i saj janë përherë në zemrën dhe mendjen e tij.

Fajoni: Kosova ka përmbushur kushtet e fundit për vizat

BRUKSEL, 15 MAJ (ER) - Raportuesja e Kosovës për liberalizimin e vizave në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, është takuar të martën në Bruksel me zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në vendin tonë dhe për pro-

cesin e liberalizimit të vizave. Fajoni ka thënë se Kosova ka përmbushur kushtet e fundit për liberalizimin e vizave. "Patëm një takim me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Enver Hoxhaj dhe një diskutim një orë e gjysmë për situatën në Kosovë. Ramë dako-

rd që heqja e vizave për njerëzit në Kosovë është një qëllim i për-bashkët, pasi vendi ka përmbushur kushtet e fundit", ka shkruar Fajoni në llogarinë e vet në "Twitter". Hoxhaj është takuar edhe me komisionarin për Zgjerim dhe Fqinjësi të Mirë, Johannes Hahn, si dhe me

komisionarin për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, me të cilët ka diskutuar për Kosovën, rajonin dhe Bashkimin Evropian. Temë e këtyre takimeve të Hoxhajt ishte liberalizimi i vizave për Republikën e Kosovës.



Mbahet konferenca "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur"

Haradinaj paralajmëron se ushtria do të bëhet edhe me ligj

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar se Kosova nuk mund të presë pakufi për transformimin e FSK-së në ushtri. Në konferencën me temë "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur", në të cilën kanë marrë pjesë ambasadorët e akredituar në Kosovë, Haradinaj ka thënë se tani janë përmbushur argumentet e nevojshme që të bëhet transformimi i FSK-së. Sipas tij, ky proces do të ndodhë me apo pa ndryshime kushtetuese

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura do të bëhet me apo pa ndryshime kushtetuese. Në konferencën me temë "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur" të organizuar nga zyra e tij, në të cilën kanë marrë pjesë ambasadorët e akredituar në Kosovë, kreu i ekzekutivit ka deklaruar se i ka përmbushur argumentet e nevojshme që të ndodhë trans-

formimi i FSK-së në ushtri të Kosovës. "Është paraparë që ndryshimet kushtetuese, fuqizimi i mandatit të FSK-së, të bëhet përmes ndryshimeve të neneve kushtetuese. Unë mendoj se argumentet për ta marrë besimin e të zgjedhurve serbë, në këtë rast të Listës Serbe, vërtet janë plotësuar, mirëpo vendimi është politik", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka përmendur edhe faktin se Qeveria ka kaluar nëpërmjet procesit të konsultimit dhe diskutimit në përgjithësi me të gjitha partitë politike dhe komunitetet etnike

brenda vendit, duke zhvilluar një dialog me të gjithë partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë dhe Qeveria vazhdon ta mbështesë këtë dialog. "Kosova është shtëpia jonë, prandaj dëshirojmë t'jua konfirmojmë para jush përkushtimin tonë, se jo vetëm FSK-ja e sotme, por edhe ushtria e ardhshme e Kosovës është forca e çdo qytetari që jeton brenda vendit, është partneritet për paqe, për siguri në rajonin tonë. Ky është vetëm një plotësim i mandatit të KFOR-it brenda vendit. Ne nuk dëshirojmë të jemi në konflikt me mandatin e KFOR-it. KFOR-i është i mirëseardhur tash e gjithmonë si forcë e sigurisë dhe kjo na ndihmon të kemi siguri jo vetëm për popullatën në Kosovë, por edhe një kontribut të madh në rajon", ka thënë Haradinaj.

Pas këtij takimi, shefi i Qeverisë ka mbajtur edhe një konferencë për medie, në të cilën ka folur për mesazhet që ua ka drejtuar ambasadorëve të akredituar në Kosovë. "Një ditë ne duhet të

veprojmë, sepse nuk mund të presim pakufi. E kam sqaruar në këtë konferencë, se ka ardhur koha të veprojmë", ka thënë ai. Sipas Haradinajt, tani transformimi i FSK-së është çështje politike. "Të gjithë jemi në punë e sipër për ta shpjeguar gjendjen e FSK-së, të arriturat e FSK-së, veçanërisht të vërtetën se FSK-ja është forcë shumetnike. Kur them shumetnike them se në FSK shërbejnë serbët e Kosovës dhe ata të veriut. Kam pasur nderin të ndaj diplomatë për kadetët e ri serbë të veriut. Po e theksoj këtë pjesë se edhe serbët janë pjesë e FSK-së, sepse është paraparë që fuqizimi i mandatit të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Mendoj se argumentet për ta marrë besimin e të zgjedhurve serbë, në këtë rast të Listës Serbe, vërtet janë plotësuar, mirëpo vendimi është politik dhe, meqenëse është politik, nuk e kemi të qartë këtë votë", është shprehur ai, duke sqaruar edhe raportin që ushtria e ardhshme e Kosovës do të kishte me KFOR-

in, i cili kujdeset për sigurinë në Kosovë. "Transformimi i FSK-së në ushtri nuk nënkupton marrjen e detyrave nga KFOR-i, që është forcë paqeruajtëse, që është mandat i NATO-s. Ne e respektojmë. E vetmja gjë që ushtria e Kosovës bën, është se ia lehtëson jetën edhe më shumë KFOR-it në Kosovë", ka thënë Haradinaj. Ai ka paralajmëruar se transformimi i FSK-së në ushtri mund të ndodhë edhe pa ndryshime kushtetuese. "Jam i bindur se nëse jo përmes bazës kushtetuese, atëherë përmes bazës ligjore do të ndodhë transformimi i FSK-së në ushtri", ka thënë kryeministri Haradinaj. Në konferencën me temë "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur", e organizuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës, kanë marrë pjesë ambasadorët e akredituar në Kosovë, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, gjenerali i FSK-së, Rrahman Rama, drejtori i NALT për Kosovën, gjeneral Ralf Hoffmann dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve në vend.



Veseli vlerëson kontributin e UNICEF-it dhënë për fëmijët e Kosovës



PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në takim drejtoreshën regionale të UNICEF-it për Evropë dhe Azi Qendrore, Afshan Khan. Në takim është diskutuar për rolin që UNICEF-i ka luajtur dhe luan në botë, për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për ta.

Kreu i Kuvendit ka falënderuar drejtoreshën Afshan Khan për kontributin që UNICEF-i ka dhënë për fëmijët e Kosovës

gjatë luftës dhe pas saj. Veseli e ka njoftuar udhëheqësen e UNICEF-it për rolin dhe angazhimin e Kuvendit për hartimin e bazës ligjore për mbrojtjen dhe sigurimin e qasjes së fëmijëve pa dallim, në të gjitha shërbimet e nevojshme për ta. Drejtoresha regionale e UNICEF-it për Evropë dhe Azi Qendrore, Afshan Khan, foli për angazhimet e UNICEF-it në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në Kosovë, për t'i siguruar të drejtat e fëmijëve të çdo komuniteti.

Flet për "Epokën e re", Mahir Jagxhillar

Reformimi i administratës publike,



- Ligji për Pagat do të procedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës gjatë muajit qershor

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se janë duke punuar për krijimin e një administrate publike moderne, të qëndrueshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe të bizneseve. Ai ka treguar se aktualisht MAP-i është në fazën finale të rishikimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jagxhillari ka deklaruar se reformimi i administratës publike do të jetë proces i pandalshëm. Ministri Jagxhillar ka paralajmëruar se gjatë muajit qershor do të dërgohen për miratim në Qeveri tri ligjet bazike të administratës publike: Ligji për Pagat, Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për Organizimin e Administratës Publike

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jagxhillar, ka thënë të martën se procesi i reformimit të administratës publike do të jetë i pandalshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka bërë me dije se ministria që drejton është duke punuar për krijimin e një administrate publike moderne, të qëndrueshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe

bizneseve. "Siç e dini, reforma e administratës publike është një proces që kërkon kohë. Aktualisht jemi në fazën finale të rishikimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020. Procesi i reformimit të administratës publike është fokusuar në ndryshimin apo reformimin përmes pakos legjislative dhe përmban Projektligjin për Shërbimin Civil, Projektligjin për Pagat dhe Projektligjin për organizimin e administratës publike", është shprehur Jagxhillari.

Ai ka treguar se në agjendën e reformave nuk është paraparë largimi i punonjësve, por profesionalizimi dhe efikasiteti i administratës publike. "Në qoftë se dëshirojmë të kemi shtet funksional, ofrim të shërbimeve me cilësi, llogaridhënie

dhe transparencë më të lartë të institucioneve, atëherë duhet t'i zbatojmë standardet e përcaktuara me parimet e administratave publike të shteteve të Bashkimit Evropian. Në agjendën e reformave nuk është paraparë largimi i punonjësve nga administrata, por është paraparë profesionalizimi dhe efikasiteti i administratës publike të institucioneve", ka deklaruar ai.

Ministri Jagxhillar ka bërë me dije se gjatë muajit qershor MAP-i do t'i dërgojë për miratim në Qeveri tri ligjet bazike të administratës publike: Ligjin për Pagat, Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për Organizimin e Administratës Publike. "Pakoja ligjore për administratë publike që përfshin Draftligjin për Organizimin dhe

proces i pandalshëm



Funksionimin e Administratës Publike dhe Agjencive të Pavarura, Shërbimin Civil dhe Ligjin për Paga, do të procedohet në Qeveri gjatë muajit qershor të këtij viti. Ne jemi duke punuar intensivisht për finalizimin e pakos ligjore të reformave në administratën publike", ka theksuar Jagxhillari.

"Epoka e re": Z. Jagxhillar, një prej kushteve kryesore për afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian është reformimi i administratës publike. Si është duke ecur procesi i reformave në administratë?

Jagxhillar: Siç e dini, reforma e administratës publike është një proces që kërkon kohë. Aktualisht jemi në fazën finale të rishikimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020. Procesi i

reformimit të administratës publike është fokusuar në ndryshimin apo reformimin përmes pakos legislative që përmban Projektligjin për Shërbimin Civil, Projektligjin për Pagat dhe Projektligjin për Organizimin e Administratës Publike. Si dhe nga ana tjetër, me zbatimin e Kornizës Strategjike për Reformën e Administratës Publike që përbëhet nga katër strategji: Strategjia e Koordinimit të Politikave, Strategjia e Rregullimit më të Mirë (Legjislacionit), Strategjia e Modernizimit të Administratës Publike dhe Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike.

"Epoka e re": Ky vit do të jetë vendimtar për reformën e administratës. Si e shihni në

përgjithësi përfundimin e këtij procesi?

Jagxhillar: Ne jemi duke punuar për krijimin e një administrate publike moderne, të qëndrueshme dhe të paanshme, në shërbim të qytetarëve dhe të bizneseve. Kështu që, duhet të zbatohen strategjitë, konkluzionet nga takimet me BE-në si dhe nga Agjenda për Reforma Evropiane.

"Epoka e re": Sa do të jenë sfiduese për ju si ministër modernizimi dhe avancimi i administratës publike duke pasur parasysh se në Kosovë administrata është e mbipopulluar dhe e politizuar? Do të ketë depolitizim të administratës publike si dhe largime nga vendet e punës?

Jagxhillar: Reformimi i administratës publike është një proces i pandalshëm, mirëpo ne si ministri jemi të fokusuar për përmbushjen e objektivave për reformimin e administratës publike të përcaktuara me dokumentet strategjike 2015-2022. Në qoftë se dëshirojmë të kemi shtet funksional, ofrim të shërbimeve me cilësi, llogaridhënie dhe transparencë më të lartë të institucioneve, atëherë duhet t'i zbatojmë standardet e përcaktuara me parimet e administratave publike të shteteve të Bashkimit Evropian. Në agjendën e reformave nuk është paraparë largimi i punonjësve nga administrata, por janë paraparë profesionalizimi dhe efikasiteti i administratës publike të institucioneve.

"Epoka e re": Si qëndron Ministria e Administratës Publike sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Agjenda e Reformave Evropiane?

Jagxhillar: Ministria e Administratës Publike, në zbatim të obligimeve të Agjendës për Reforma Evropiane, ka realizuar analizën cilësore të institucioneve dhe agjencive të pavarura dhe, krahas saj, ka hartuar konceptdokumentet për organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe paga. Koncept-dokumentet për organizimin e administratës publike dhe shërbimin civil janë miratuar nga Qeveria më 15 maj të vitit 2017, ndërsa koncept-dokumenti për paga është miratuar nga Qeveria më 9 mars të këtij viti. Grupi punues ka hartuar Draftligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Publike dhe të Agjencive të Pavarura, Shërbimin Civil dhe Ligjin për Paga, prandaj gjatë muajit maj do ta fillojmë zhvillimin e konsultimeve publike.

BE-ja: Kosova po bën reforma përmbajtjesore në administratën publike

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Progresi në administratën publike në Kosovë është diskutuar në takimin e grupit të veçantë për Reformë të Administratës Publike (RAP) në Prishtinë, i cili është mbajtur më 26 prill të këtij viti. Siç ka njoftuar Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE), vendi ynë është duke zhvilluar reforma përmbajtjesore të administratës publike, nën udhëheqjen e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Zyrës së Kryeministrit. "Komisioni Evropian (KE) ka mirëpritur paketën e planifikuar legislative të ligjeve, që përfshin ligjet mbi zyrtarët publikë, Ligjin për pagat dhe Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. Gjithashtu, komisioni mirëpret faktin se kjo paketë po përgatitet në një mënyrë të koordinuar, ashtu siç është zotuar Kosova se do të veprojë në dialogun e politikave për reformën e administratës publike të ngritur në kuadër të MSA-së", është thënë në njoftimin e Zyrës së BE-së në Kosovë. Po në këtë njoftim është thënë se BE-ja mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën në reformimin e administratës publike. "Për këtë arsye, BE-ja dhe Kosova kanë lidhur një kontratë për reformë sektoriale për reformë të administratës publike, e cila parashikon një ndihmë financiare prej 25 milionë eurosh për Kosovën deri në vitin 2021. Kjo ndihmë

është e ndarë në katër pagesa, me një shumë maksimale prej 22 milionë eurosh në Buxhetin e Kosovës dhe tre milionë euro asistencë teknike. Pagesat në buxhet janë të kushtëzuara me përparim në reforma dhe në përmbushjen e synimeve që janë rënë dakord reciprokisht. Një pagesë prej 5.5 milionë eurosh është planifikuar për disbursim në vitin 2018, nëse Kosova plotëson kushtet e përcaktuara në kontratë. Këto kushte kanë të bëjnë me përparimin e bërë në zbatimin e reformave të administratës publike dhe menaxhimit të financave publike, në zbatimin e politikave makroekonomike të orientuara drejt stabilitetit dhe në rritjen e transparencës së buxhetit", është thënë në këtë njoftim. Krejt në fund, sipas këtij njoftimi, reforma në administratën publike synon t'i mbulojë këto fusha: politikën dhe zhvillimin legjislativ gjithëpërfshirës dhe të bazuar në fakte, përmirësimin e qasjes publike në dokumente, përmirësimin e profesionalizmit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, zvogëlimin e barrës administrative për qytetarët dhe bizneset, përmirësimin e planifikimit të politikave, administratën shtetërore më racionale dhe llogaridhënëse dhe qasjen e përmirësuar në drejtësinë administrative.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj, ministrave: Jepuni punë zëvendësministrave

Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar të martën nga ministrat t'u gjejnë punë zëvendësministrave. Teksa e ka informuar kabinetin qeveritar me raportin e punës së zëvendësministrave, Haradinaj ka thënë se nga ky raport shihet se ka pasur angazhim konkret të zëvendësministrave

**EPOKA
ERE****Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 15 MAJ - Kabineti qeveritar është informuar me raportin e punës së zëvendësministrave, i cili është përgatitur nga raportet e pranuar nga secili zëvendësministër. Në bazë të raportit është vlerësuar se ka pasur angazhim konkret të zëvendësministrave dhe është dëshmuar se ata janë në nivel të përgjegjësisë të tyre. Kryeministri Ramush Haradinaj në mbledhjen e Qeverisë mbajtur të martën ka kërkuar të vazhdohet angazhimi i tyre në punë, me qëllim të çuarjes përpara të proceseve të rëndësishme për vendin. "Kam mbajtur një takim me zëvendësministrat. Shumica kanë dëshmuar një shkallë të seriozitetit të punës në raportet që kanë sjellë", ka thënë Haradinaj, duke i ftuar ministrat të kenë koordinim më të mirë me zëvendësministrat e tyre. "Një lutje e kam për ministrat, koordinoheni me zëvendësministrat

më shumë. Edhe pse është një numër prej 74 sish zëvendësministra, arsyeshmëria mund të argumentohet nëse jepet punë. Pra, ju kisha lutur jepuni punë", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Kabineti qeveritar është informuar edhe për vizitën e delegacionit të shtetit të Iowas në Kosovë. Gjatë qëndrimit në Kosovë ky delegacion, përveç takimeve me krerët institucionalë, ka arritur të nënshkruajë një sërë marrëveshjes në sektorë të ndryshëm, veçmas në atë të arsimit që janë të rëndësishëm për vendin.

Kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga secili institucion që ka qenë i përfshirë në këto marrëveshje të jenë në gjendje gatishmërie për t'i zbatuar ato.

Në mbledhjen e kabinetit qeveritar është miratuar koncept dokumenti për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Qëllimi kryesor i këtij koncept dokumenti është të verifikohen ndryshimet e fundit të

legjislacionit evropian dhe të balancohen detyrimet e Kosovës që rrjedhin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim, në mënyrë që të jenë përputhje me legjislacionin e BE-së. Po ashtu, edhe koncept dokumenti për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës ka marrë miratimin në mbledhjen e kabinetit qeveritar. Ky koncept dokument synon ta nxisë krijimin dhe zhvillimin e politikave, ambientit, mekanizmeve dhe infrastrukturës kulturore me qëllim të krijimit të kushteve adekuate teknike dhe profesionale.

Një prej çështjeve më të rëndë-

sishme në këtë kuadër është mbështetja e institucioneve publike të kulturës, si parakusht të përmbushjes së misionit të këtyre institucioneve. Kabineti qeveritar ka miratuar përditësimin e listës shtetërore të mallrave të kontrolluara strategjike, përfshirë edhe listën evropiane të mallrave me përdorim të dyfishtë, listat e përbashkëta ushtarake dhe mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të të drejtave të njeriut.

Po në këtë mbledhje është marrë

vendim për themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. A., në të cilën aksionare do të jetë Qeveria e Kosovës.

Raporti vjetor i statistikave zyrtare për vitin 2017 ka marrë miratimin e Qeverisë. Raporti do të përcillet në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

Qeveria ka emëruar Behxhet Rukiqin drejtor të Agjencisë Qendrore të Prokurimit është emëruar. Ndërsa drejtoreshë e përgjithshme në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është emëruar Nexhmije Selimi.

Kastriot Sylejmani lë profesionin e gazetarit, i bashkohet Nismës



PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Kastriot Sylejmani, i cili ka ushtuar profesionin e gazetarit në televizionin Kohavision (KTV), i është bashkuar partisë së Fatmir Limajt, Nismës Socialdemokrate. Sylejmani është zgjedhur koordinator i Nismës Socialdemokrate për qytetin e Vitisë. Me të marrë këtë post, të koordinatorit të

Nismës për Viti, Kastriot Sylejmani ka thënë se Nisma Socialdemokrate që prej themelimit ka dëshmuar se interesin e shtetit e ka në rend të parë. "Nisma në Qeveri po jep shembull se si punohet në shërbim të qytetarëve dhe në të mirë të vendit. Rrugëtimi ynë ka për qëllim përmirësimin e jetës së qyte-

tarëve. Nisma Socialdemokrate ka pasur shtrirje në komunën tonë dhe, pavarësisht prej sfidave, ajo ka arritur të jetë afër qytetarëve dhe elektoratit të vet. Si koordinator i degës bashkë me ekipin punues do të angazhohem që Nisma të jetë faktor në nivel lokal dhe në atë qendror", ka thënë Sylejmani.

Vetëvendosja përforcohet me ish-zyrtarin e Zyrës së UÇK-së në Prishtinë

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se kësaj lëvizje i është bashkuar Driton Hyseni, i cili kishte punuar së bashku me Kurtin në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. "Para dy dekadash kemi punuar bashkë në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. Sot na u bashkua në Vetëvendosje Driton Hyseni,

inxhinier i kompjuterikes, magjistër në drejtimin e biznesit ndërkombëtar dhe ekspert në fushën e aviacionit civil. Dritoni është i dëshmuar në luftë e në paqe, i përgatitur politikisht e profesionalisht. Punëve e angazhimeve tona, sidomos në Llap e në Prishtinë, iu shtua dije dhe energji", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



Myftiu Tërnavë uron besimtarët myslimanë për muajin e Ramazanit



Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, ka uruar qytetarët e besimit islam për fillimin e muajit të shenjtë të Ramazanit. Ai ka thënë se agjërimi është kurs edukativ që përgjatë një muaji formësohet në mënyrë të përsosur personaliteti i besimtarit dhe lidhjet e tij me Zotin

EPOKA ERE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit, ka uruar qytetarët e besimit mysliman, duke u dëshiruar agjërim të lehtë. Në një konferencë për medie Tërnavë ka thënë se në esencë agjërimi është kurs edukativ që përgjatë një

muaji formësohet në mënyrë të përsosur personaliteti i besimtarit dhe lidhjet e tij me Zotin. "Të nderuar besimtarë, vëllezër dhe motra, duke filluar nga sot (e mërkurë) myslimanët anëmbanë botës fillojnë agjërimin e muajit Ramazan. Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe në emër të institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, u uroj për ardhjen e këtij muaji të bekuar të gjithë bes-

imtarëve të besimit islam kudo që ata gjenden, në Kosovë dhe jashtë saj, duke e lutur Zotin të na lehtësojë agjërimin dhe të gjitha adhurimet e tjera, të na fisnikërojë me moralin dhe etikën e Ramazanit, si dhe të na falë e të na mëshirojë! Urime të gjithëve muaji i Ramazanit! Ndonëse formalisht manifestohet duke abstenuar nga ushqimet dhe pijet, në esencë agjërimi është një kurs edukativ, i cili përgjatë një muaji të tërë në mënyrë intensive punon për ta formësuar në mënyrë ta përsosur personalitetin e besimtarit dhe lidhjet e tij me Zotin dhe të tjerët", është shprehur Tërnavë. Ai ka thënë se largimi nga ushqimi dhe pijet është mënyrë për të arritur tek qëllimi final, që është

devotshmëria ose lidhja e njeriut me krijuesin. "Ramazani në mënyrë simbolike shënon edhe fillimin e shpalljes së Kuranit, i cili përshkruan më së miri rrugën që ne duhet ndjekur për të realizuar këtë qëllim, pra devotshmërinë. Në Ramazan lidhja e njeriut me zotin bëhet edhe më e fuqishme për shkak të mundësive të shumta që zoti i ka lënë në dispozicionin tonë për të na falur dhe mëshiruar. Ramazani, thënë në mënyrë figurative, është rrezatim i dashurisë dhe mëshirës së zotit ndaj njeriut andaj, duke u nisur nga këto tipare të krijuesit, edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin dhe të jemi të mëshirshëm ndërmjet vete", ka deklaruar Tërnavë. Myftiu ka treguar se agjërimi është një proces i cili gdhend

Ndërtimi i xhamisë do të nisë së shpejti

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, një ditë para fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit ka bërë me dije se ndërtimi i xhamisë së madhe në Prishtinë do të fillojë së shpejti. Myftiu ka prezantuar edhe një fotografi para gazetarëve se si do të duket xhamia. "Pamja prapa meje është e xhamisë. Do ta fillojmë kur ka thënë Zoti", ka thënë myftiu Tërnavë.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të anëtarësohen njëkohësisht në BE

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur të martën një tryezë në prag të Samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, me synimin që të diskutohet rreth gjendjes socio-politike dhe ekonomike të shqiptarëve në shtetet e ndryshme të Ballkanit dhe interesat kombëtare të shqiptarëve në raport me procesin e integrimit evropian, duke bërë krahasimin edhe me kombet e tjera të rajonit. Në këtë diskutim morën pjesë profesorë, historianë, publicistë, gazetarë e pjesëtarë nga shoqëria civile. Nga kjo tryezë e mbajtur në ambientet e Kuvendit të Kosovës dhe e udhëhequr nga kryetari i Lëvizjes, Albin Kurti, dolën pesë pika që mund ta përmbledhin diskutimin e gjatë të tryezës që zgjati rreth tri orë: 1. Integrimi i

shqiptarëve në Bashkimin Evropian është interes dhe vlerë. Anëtarësimi nuk do të thotë se do të shkojmë në BE, por të bëhemi anëtar në BE; 2. Gjashtë vendet në Ballkanin perëndimor të integrohen njëkohësisht. Politikanët e diplomatët shqiptarë ta kërkojnë këtë në Samitin Evropian në Sofje; 3. Zhvillimi ekonomik i përqendruar në punësim dhe drejtësia ligjore e sociale të jenë prioritet si për pushtetin, po ashtu edhe për opozitën; 4. Të bëhet bashkërendimi i faktorëve politikë në Kosovë dhe të shqiptarëve në përgjithësi për politikë të jashtme të harmonizuar; dhe 5. Duhet punuar me pesë shtetet mosnjohëse të pavarësisë së Kosovës që janë anëtarë në Bashkimin Evropian, megjithatë ata nuk duhen konsideruar të njëjtë.



Kosova do t'i forcojë lidhjet ekonomike me Baden Wurttembergun



PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - "Partneriteti Kosovë-Gjermani prej dy dekadash është dëshmi e orientimit të Kosovës drejt familjes evropiane", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj pasi ka pritur në takim një delegacion nga shteti i Baden Wurttembergut, i kryesuar nga Gisela Erler, këshilltare shtetërore.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se partneriteti me shtetin gjerman është strategjik dhe nuk ka asnjë argument apo pengesë

që mund të na ndajë. "Që nga viti 1999 Gjermania ka qenë e pranishme në Kosovë, duke e ndihmuar vendin tonë nëpër të gjitha fazat e shtetndërtimit. Tani kjo prani, e nisur nga ajo ushtarake që ka siguruar paqen, po shndërrohet në partneritet ekonomik. Ne kemi themeluar 'Parkun Inovativ Trajnues' në Prizren, që do të jetë qendër ekonomike, edukuese dhe trajnuese, projekt i përbashkët me Gjermaninë", është shprehur Haradinaj, duke kërkuar nga del-

egacioni mbështetjen e Kosovës në fushat e ndryshme, veçmas në fushën e edukimit dhe në fushën e bujqësisë.

Kryesuesja e delegacionit gjerman, Gisela Erler, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen, derisa ka treguar se arsyeja e vizitës është thellimi i bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Baden-Wurttemberg, veçmas në fushën e arsimit, me theks të veçantë programeve profesionale të edukimit dhe zhvillimin e bujqësisë. "Ne jemi

shumë të lumtur dhe tejet të interesuar si shtet, ta mbështesim Kosovën në rrugën evropiane. Ajo që kemi parë në Kosovë është tejet mbresëlënëse. Dëshirojmë që këtë energji ta konkretizojmë me projekte të tjera", ka thënë kryesuesja e delegacionit gjerman Gisela Erler.

Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar delegacionin me të gjitha të arriturat në Kosovë, me progresin për luftimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit, përbushjen e kriterëve

për liberalizimin e vizave, progresin ekonomik dhe të arriturat e tjera në vend. "Kosova ka bazën e përshtatshme ligjore të të bërit biznes, ka resurset humane dhe ne mbështesim projektet gjermane në fushën e arsimit, teknologjisë, energjisë dhe bujqësisë", ka thënë Haradinaj. Pjesë e takimit ishte edhe zëvendësambasadori gjerman në Kosovë, Jan Axel Voss, Blerim Canaj dhe Besnik Miftaraj nga Konsullata e Kosovës në Baden-Wurttemberg.

Vala sjell pako të reja PostPaid



vala POSTPAID						
PAKOT POSTPAID INDIVIDUALE						
	ÇMIMI	MINUTA VALA	MINUTA KOMBËTARE	SMS VALA/KOMBËTARE	INTERNET 3G/LTE	BONUSI
IN	11.82€	500	100	1000	5GB	75€
PLUS	19.74€	800	200	2000	7GB	125€
ELITE	26.20€	1200	350	3000	10GB	210€
SUPER	37.45€	2500	500	5000	15GB	300€
PREMIUM	43.28€	Pa limit	1000	10000	20GB	520€

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 MAJ - Në një mjedis dinamik, konkurrues dhe me kërkesa të shtuara për produkte atraktive dhe të leverdishme, Telekom i Kosovës, Vala, ka nxjerrë në treg pako të reja të telefonisë mobile, për t'i përbushur nevojat e konsumatorëve dhe qytetarëve për komunikim dhe internet të shpejtë. Ky produkt përmban pesë pako, ku si fokus

kryesor është rritja e sasisë së internetit, duke filluar nga 5GB deri në 20GB, përfshirë edhe minuta e sms shtesë.

Gjatë vizitës së tij në pikën e shitjes në Sheshin "Nënë Terezë", ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të PTK-së, Zeqir Kiqina, pati rastin që, përveç stafit, të takojë edhe disa konsumatorë.

Me këtë rast, ai ia ka prezantuar pakot e reja një konsumatori me parapagim, i cili u shpreh shumë i kënaqur dhe vendosi

të lidhë kontratë për shërbimet PostPaid. "Ne kemi dashur të krijojmë diçka të veçantë për konsumatorët tanë besnikë që ndër vite kanë qëndruar pranë Telekomit të Kosovës. Këto pako janë shumë të përshtatshme, pasi do t'u mundësojnë konsumatorëve PostPaid të telefonisë mobile, të komunikojnë pandërprerë dhe ta shfletojnë internetin, me çmime shumë të lira. Përveç kësaj, duam t'u inkurajojmë konsumatorët

tanë PrePaid të lidhin kontrata të volitshme me Telekomin e Kosovës për shërbime PostPaid", ka thënë Kiqina. Me pakot e reja individuale PostPaid synohet të plotësohen të gjitha nevojat dhe kërkesat e klientëve ekzistues dhe atyre të rinj. Dizajnimi dhe përmbajtja e këtyre pakove është orientimi nga shfrytëzueshmëria maksimale e internetit, që është kërkesë e vazhdueshme e klientëve tanë, pako këto të shumëkërkuara nga shfry-

tëzuesit e pakove individuale. Pakot e reja PostPaid do të jenë në dispozicion të konsumatorëve në të gjitha pikat e shitjes së Telekomit të Kosovës anekënd vendit. Telekom i Kosovës, Vala, si kompani udhëheqëse në sektorin e telekomunikacionit në vendin tonë, do të vazhdojë të ofrojë shërbime dhe produkte atraktive dhe të leverdishme, duke përbushur kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve për komunikim sa më cilësor.

Kosova përfiton 5.4 milionë euro për menaxhimin e mbeturinave

Qeveria e Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë, e përfaqësuar nga Banka Zhvillimore Gjermane (KfW), kanë nënshkruar dy marrëveshje grant për projektet: Programi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në vlerë prej katër milionë eurosh dhe Shërbime profesionale të pranuesit në kuadrin e programit ii të menaxhimit të mbeturinave në vlerë prej 1.4 milion eurosh



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe drejtori i Departamentit të Infrastruktura Komonale për Evropën Juglindore dhe Turqi në Bankën Zhvillimore Gjermane (KfW), Kirk Mildner, kanë nënshkruar të martën dy marrëveshje për grant për menaxhimin e mbeturinave. Kjo marrëveshje arrin shumën e 78 milionë eurove që Kosova përfitoi grante në mandatin e ministrit të Financave, Bedri Hamza.

Marrëveshja në fjalë kap shifrën prej 5.4 milionë eurosh dhe siguron mjete për dy projekte: Programi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta që kap vlerën prej katër milionë eurosh dhe Shërbime profesionale të pranuesit në kuadrin e programit ii të menaxhimit të mbeturinave që kap vlerën prej 1.4 milion eurosh.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se bashkëpunimi me Qeverinë e Gjermanisë ka prodhuar shumë projekte të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm jetën e qytetarëve të Kosovës. "Pa dyshim se sektori i ambientit është sektori i radhës ku do të investojmë. Nevojat janë jashtëzakonisht të mëdha në nivel lokal dhe qendror", ka thënë Hamza, duke shtuar se ministria të cilën e udhëheq vazhdimisht është duke punuar së bashku me donatorë dhe institucione financiare ndërkombëtare. "Këto investime është e domosdoshme t'i bashkërendojmë edhe me rritjen e vetëdijes sonë si qytetarë për ruajtjen më të madhe të ambientit. Për mua sot është kënaqësi e veçantë nënshkrimi i dy marrëveshjeve për sektorin e ambientit. Fjala është për dy projekte për mbeturina të ngurta, respektivisht: 1.46 milion euro përdoren për studim

fizibiliteti për identifikim të nevojave për investime shtesë në deponitë nacionale të mbeturinave dhe katër milionë euro do të përdoren për masa investive për disa komuna të Kosovës të cilat përmes një konkursi nga GIZ-i kanë dalë fituese", ka thënë Hamza.

Ai ka bërë me dije se komunat do të përfitojnë kontejnerë të llojeve të ndryshme për grumbullim dhe seleksionim, makineri dhe pajisje të tjera për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, pajisje për pastrimin e

rrugëve, materiale dhe pajisje për përmirësimin e operimit dhe mirëmbajtjes, shërbime këshilluese të drejtuara kah planifikimi dhe zbatimi i masave të lartpërmendura.

Ministri Hamza ka treguar se që nga fillimi i mandatit të tij janë nënshkruar 72.4 milionë euro grante (para falë), ku me marrëveshjet e fundit kjo mbërrin shumën prej 78 milionë eurosh.

Sekretarja e parë e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Anja Becky, ka shprehur vlerësimin

më të lartë me rastin e nënshkrimit të këtyre dy marrëveshjeve shumë të rëndësishme. Ajo ka thënë se Qeveria e Gjermanisë është krenare që i ofron këto grante sektorit të mbeturinave të ngurta në Kosovë.

Ndërsa drejtori i Departamentit të Infrastruktura Komonale për Evropën Juglindore dhe Turqi në KfW, Kirk Mildner, ka thënë se këto marrëveshje janë dëshmi të një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm të cilën e gëzojnë me institucionet e Kosovës.

Lekaj: Po punojmë çdo ditë për zhbllokimin e rrugës për Shkup

EPOKA ERE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Infrastruktura Komonale, Pal Lekaj, ka reagu ndaj raportimit të medieve lidhur me reagimet që kanë ardhur pas mbylljes së qarkullimit rrugor në segmentin Kaçanik-Hani i Elezit. Ai ka bërë me dije se që nga e enjtja do të fillojnë punimet në rrugët lokale për t'i zgjidhur problemet e fshatrave që i përshkon kjo rrugë.

Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut, Ylber Bajra, të martën nëpërmjet një letre të hapur ka kërkuar nga kryeministri, Ramush Haradinaj, shkarkimin e ministrit Lekaj për shkak të këtij vendimi. Megjithatë, Lekaj në reagimin e tij ka thënë se vendimi nuk është marrë 'për qejf' dhe ka bërë thirrje për bashkëpunim e jo për, siç e ka quajtur ai, 'zhurmë sa për lajme'. "E kam theksuar, po e ritheksoj përsëri,

vendimi që të ndalohet lëvizja në rrugën Kaçanik - Hani i Elezit nuk është marrë për teke personale, por pas vlerësimeve të ekspertëve se çdo ditë e më shumë përbën rrezik dhe rrjedhimisht duhet të veprohet që të ruhet jeta e qytetarëve, më së shumti e njerëzve të Kaçanikut, të Elezi Hanit, pastaj për të gjithë të tjerët që e frekuentojnë atë segment", ka thënë Lekaj.

Ai ka bërë me dije se çdo ditë është duke u punuar që të bëhet zgjidhje e shpejtë dhe rruga të rikthehet në funksion. "Nuk guxojmë të lejojmë që gjërat të bëhen vetëm sa për të thënë. Çdo ngutje nënkupton diçka tjetër, e mund të përsëritet ajo që ka ngjarë thuajse në çdo vit, sepse asnjëherë nuk është zgjidhur që sa vite ashtu siç duhet, e për t'u sanuar problemi njëherë e përgjithmonë", ka thënë ministri Lekaj. Ai ka theksuar se të gjithë duhet të kontribuojnë që çështja e 'bllokimit'



it' të aksit rrugor që na lidhë me Maqedoninë ta marrë zgjidhjen e duhur dhe jo të bëhet thirrje

siç e ka quajtur ai, "demonogjike dhe linçuese". Rruga Kaçanik - Hani i Elezit

ishte mbyllur më 8 maj pas vlerësimit se ekziston rrezik nga shembja e kodrës.

Rahoveci pranon donacion prej 95 mijë eurosh nga DEMOS-i

RAHOVEC, 15 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar të martën pranimin e donacionit nga DEMOS-i në vlerë prej 95 493 eurosh. Latifi ka bërë me dije se kjo marrëveshje përbën një element të rëndësishëm për investimet kapitale që do të bëhen në komunën tonë.

"Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje i hapim rrugë një investimi të ri në vlerë prej 75 000 eurosh për qytetarët e Xërxës, i cili dedikohet për ndriçim publik si dhe 25 000 euro për rregullimin e hapësirave gjelbëruese në qytetin e Rahovecit", ka thënë Latifi.



Komuna e Prishtinës nis bisedimet për investime në rrjetin e kanalizimit

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Drejtori i Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave në Komunën e Prishtinës, Gëzim Mehmeti, bashkë me zyrtarë të tjerë nga kjo komunë ka takuar të martën delegacionin e KfW-së të udhëhequr nga Kirk Mildner, drejtor i divizionit për infrastrukturë komunale dhe transport për Evropën Juglindore dhe Rene Escherman, drejtor i zyrës për Kosovë dhe Maqedoni, me të cilët ka diskutuar për investimet e ardhshme

në rrjetin e kanalizimit dhe në kolektorë.

Dihet se Prishtina ka probleme me kanalizim, sidomos për shkak të rrjetit të vjetër, i cili asokohe është paraparë për shumë më pak banorë, e që nuk e përballon dot mbipopullimin që ka ndodhur pas luftës. Në këtë drejtim Komuna e Prishtinës ka orientuar investimet për ndërrimin e rrjetit të kanalizimit brenda qytetit.

Aktualisht është duke u punuar në rrugët "Fehmi Agani",

"Çajupi", "Hajdar Dushi", "Meto Bajraktari", në muajin tjetër do të vazhdohet në rrugët "Andre Gropa" dhe "Bedri Pejani".

Zyrtarët e Komunës së Prishtinës kanë bërë me dije se bashkëpunimi me KfW-në do të thellohet edhe më tutje, si domosdoshmëri e intervenimeve të përbashkëta në infrastrukturën nëntokësore, ashtu që të evitohen problemet me kanalizim dhe ujësjellës brenda qytetit të Prishtinës.

Rugova: Mbi 300 mijë euro janë investuar nga KEDS-i në qendër të Istogut

ISTOG, 15 MAJ (ER) - Me investimet që Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim të Energjisë Elektrike (KEDS) po shtrinë në tërë Kosovën, për përmirësim dhe rritje të kualitetit dhe rënies së humbjeve në energji, është i kënaqur edhe kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova. Ai ka përmendur bashkëpunimin ndër vite në mes të komunës që ai drejton dhe KEDS-it. "Komuna e Istogut ka një bashkëpunim shumë të mirë me KEDS-in. Vazhdimisht mbajmë takime me përfaqësues të lartë të KEDS-it nga Prishtina, si dhe me përfaqësues të tjerë të cilët janë në zyrat e KEDS-it në Istog, ku komunikohet për çdo kërkesë, vërejtje apo sugjerime si nga ana e komunës, po ashtu edhe nga ankesat e qytetarëve të cilat analizohen gjithmonë nga KEDS-i si dhe komuna. Ne si komunë jemi shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga KEDS-i, sidomos në vitet e fundit që është duke investuar në renovimin e rrjetit ekzistues", ka thënë Haki Rugova.

Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka bërë me dije se KEDS-i është fokusuar në investimet në Istog, posaçërisht për shtrimin e rrjetit nëntokësor për shkak se në Istog ka erëra të forta.



Kreu i Istogut, Haki Rugova, flet me shifra për një nga investimet që Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim të Energjisë Elektrike (KEDS) i ka sjellë kësaj komune. "Komuna e Istogut vitin e kaluar, së bashku me KEDS-in, kanë realizuar një marrëveshje bashkëpunimi për projektin 'Ndërtimi i rrjetit nëntokësor në qendër të qytetit 10 dhe 30 KWL', në vlerë prej 300 000 eurosh, i cili projekt do të vazhdojë edhe këtë vit, njëkohësisht edhe instalimi i disa trafostacioneve të reja në disa fshatra të Komunës së Istogut, si dhe vazhdimi i renovimit të rrjeteve

të vjetër si dhe dislokimi i shtyllave të tensionit të ulët dhe të lartë. Kjo është për çdo mirënjohje", ka treguar numri një i Istogut.

Rugova ka pohuar se edhe projekte të tjera në vazhdimësi do të ndodhin gjatë këtij viti nga ana e KEDS-it në këtë komunë. Kryetari i Istogut kujton specifikat atmosferike që ka Istogu, që njihet edhe si rajon me erëra të forta, për çfarë thotë se KEDS-i këtë fakt e ka parasysh edhe me projektet që i sjellë. "Komuna e Istogut është në bashkëpunim të ngushtë me KEDS-in, gjithashtu duke e pasur parasysh edhe

fatkeqësitë natyrore për të cilat është edhe e njohur komuna e Istogut për erëra të forta, ku ekipet e KEDS-it kanë interven-

uar shumë shpejt dhe së bashku me organet komunale u kanë dalë në ndihmë qytetarëve", ka thënë Rugova.



Festë për Abetaren në Akrashticë të Vushtrrisë


VUSHTRRI, 15 MAJ (ER) - Në prani të prindërve, mysafirëve dhe personelit të shkollës, me poezi, këngë e valle, të martën nxënësit e Shkollës së Akrashticës në Komunën e Vushtrrisë kanë festuar "Festën e Abetares". Këta nxënës që tashmë mësimin po e zhvillojnë sipas Kurrikulës së Re janë përgëzuar edhe nga drejtori i kësaj shkolle, Hajdin Islami.

"Sukseset e shkollës sonë janë të mëdha, të gjithë jemi krenarë. Urime për ditën tuaj! Jemi të lumtur që ju po sot, edhe pse jeni në klasën e parë, keni arritur të mësoni shkrim lexim", ka thënë drejtori Islami.

Të pranishmit i kanë përshëndetur edhe mësueset e kësaj klase, Erleta Pllana dhe Lejla Ymeri - Pllana.

Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri, vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk bën të nëpërkëmbet (5)

A jemi robër të famës fitimtare më 1999 dhe si ka rrjedhur kriza?



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

E tërë politika që ushtrohet sot në Kosovë, horizontalisht nepotiste, vertikalisht injorante, por klanore, për çdo njeri të logjikshëm, duhet të jetë brengosëse. Shikoni sa seriozë janë disa njerëz për ushtrimin e marrëzive politike, të cilat kultivohen me dekada dhe populli u beson. Këtu politikanët, nëse mund të quhen kështu, shumica e të cilëve janë matrapazë, janë përçarë aq egërsisht saqë askush nuk ka autoritet t'ia mësyjë "bashkimit" të tyre. Pse? Sepse autoriteti numër një i shtetit është caktuar me diktat. Dhe, a nuk ishte pozita e politikanëve shqiptarë në këtë nivel, të gjithë të përçarë gjatë viteve 1913-1916? Faktet krahasuese dëshmojnë se po, vetëm tipat e Esadit janë më finokë, më tinëzarë, më mizorë në ndjenjë dhe më të sofistikuar nga të huajt. Çfarë ndodhi me fatin tonë pastaj dihet, çdo gjë mbeti në gjysmë të rrugës. Dhe a do ta shpijnë shqiptarizmin në greminë, për ngritjen e familjeve të tëra të korruptuara deri në skajshmëri, për primat bajraktari dhe regionit, del se po, sepse ata sot edhe fizikisht që mund të bëjnë çdo gjë, janë ndarë në nivele të përfitimit, nuk akuzohen ndër vete dhe vetëm shtypi i "denoncon, sepse legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë bërë një klan, në stilin "Ti mu, unë Ty", kanë bërë një ndarje të re të niveleve fitimprurëse nga Akademia e deri në foshnjore, nga Presidenca e deri në zyrën ku paguhen taksat e shtetit, nga mjetet e informimit publik e deri te animet private të tyre plot ngjyra politokracish. Të gjitha faktet tregojnë se këtu kemi të bëjmë me një "tabut kufomash të gjalla, që nuk shohin asgjë përpos interesit familjar dhe personal. Pse ndodhë ky fenomen, sepse në Kosovë nga OKB-ja eksperimentohet, kalkulohet, konsultohet shumë kush që është injorant, që një fakultet e ka kryer me njëqind intervenime, që nuk din çka është kultura e shkrimit, por din fare mirë çka është "kultura e përvetësimit". Por, të themi në fund se tërë këtë rreshtim po e dirigjon Beogradi, me fajin e politikanëve tanë servilë, të lidhur për pozitë, të "burgosur" me servilizëm. Këtu, nuk ka ditë që

në mjetet e informimit nuk flitet për drogë, prostitucion, korrupsion, hajni dhe fyerje nder më të egrat në Evropë. Për këtë lloj shoqërie dihet se nuk është bërë luftë çlirimtare, nuk është themeluar UÇK-ja. Dhe shtrohet pyetja, a ia vlen të bësh luftë politike me këtë shtresë të paarsimuar në Kosovë, kur çdo gjë është stralluar dhe determinuar të eksperimentohet dhe eventualisht të dështohet duke u mbështjellë tërë realiteti rreth disa personaliteteve që nuk kanë arsimimin adekuat kombëtar dhe intelektual. Çka do të i ndihmojnë këta të tjerëve, kur nuk i ndihmojnë veti drejtësisht dhe me djersë të ballit të lirë. Ky soj i politikanëve është sorollatë nëpër Evropë mjaftë, dhe është kah teatizon mirëqenie të rrejshme, përmes arritjes së pavarësisë, që nuk është produkt i tyre fare. Këta në këto rrethana, nuk dinë fare të krijojnë klimë politike dhe ekonomike, për ta nxjerrë popullin dhe shtetin nga kriza. Një kohë të gjatë flasin për dofarë benifite evropiane, flasin për vizat, të cilat vet i kanë, por popullit nuk ia sigurojnë sepse pastaj "tregu i tyre i diturisë", do të shembet si kulla prej letre, sepse shumica diplomat e tyre i kanë blerë nëpër kolegje të Evropës, ose të "këtushme" e që nuk janë asgjë tjetër, vetëm një diplomë "letër pa vlerë", karshi letrave me vlerë, si thuhet me gjuhen financiare. Por, edhe sot duhet filluar dikah. Vizat do të vijnë një ditë, por ato nuk e nxjerrin Kosovën nga humnera ekonomike. A do të dali nga "populli një vullkan", sikurse ai më 28. XI. 1997, kur nga masa në varrimin i trupit të një heroi dolën tri heronj: Mujë Krasniqi, Daut Haradinaj dhe Rexhep Selimi, mendoj se frika ka vdekur përgjithmonë këtë ditë dhe ka filluar epoka e evropeizimit të vërtetë. Prandaj, popull kemi për këtë evropianizim, fusha e guximit është e gatshme, pavarësinë dhe sovranitetin duhet merituar me urti logjike, e jo me inate embrionale bajraktarësh. Po, kam besim se djallëria e Kosovës do të ftojë mbi injorancën që është stralluar, sidomos, në institucionet e larta të shtetit, por edhe në shumë komuna që nepotizmi dhe papunësia e brejnë shoqërinë-shtetin sikurse valët e detit shkëmbin. Unë kam të drejtë të shprehem kështu, sepse nuk kam bërë turr në asnjë kolltuk, por nuk kam të drejtë të kërkojë kolltukë sepse më janë ofruar. E pra të sqarojë pse i kam refuzuar, sepse ky injoranti që vjen bie fjala nga Spanja, Rumania, me një shkollë të mesme me paragykyime koloniale, të dety-

ron ta ulësh kokën dhe mos të vërsh asgjë. Bie fjala, ky problemet e të drejtave nacionale janë buzë eksplodimit, në shumë vend që këtu delegojnë miniguvernatorë, ku ai, vjen dhe nënshkrimin tim ma shndërron në zero vlerë. nuk do ta elborojë këtë fenomen, por dikush po mendon se këtu kanë qenë pushtet analfabetët dhe "komunistët" që duhet të "ngordhin sikur të ishin nga ish Rodezia". Ja ky është mentaliteti i disa miniguvernerëve në drejtësi, arsim, kulturë, ekonomi, shëndetësi, e në shumë lëmi tjera. Shqiptarët më 1999, ishin lajmi kryesor në të gjitha institucionet valide të globit. Jo pse po bënin ndonjë zbulim shkencor, ekonomik, kulturor civilizues, por po dëshmonin një perseverancë të pathyer luftë të drejtë, që bota e civilizuar do t'ua ketë lakmi dhe zili, për një kohë të gjatë, sepse po dëshmonin se nuk duan të vdesin si komb e formuar dhe i pjekur shumë mirë nga çdo nivel. Sot, çdo gjë nuk është kthyer mbrapa këtu, por po komentohet mbrapsht. Shikoni se kush komenton për çdo javë nëpër podiumet informative, është mbush Kosova me analistë?, që vetëm flasin mendime të kota dhe lavdërohet para mëhallsë së tyre se e kanë "thënë këtë dhe atë". Këta papagall, për çdo ditë i ke nëpër kafene dhe portale gazetash, që nuk preferojnë asgjë përpos politikë boshe, fraza mizantropë që tek e fundit vetëm ata i lexojnë. I lexojnë edhe ata që duan ta dinë se deri ku ka sharruar niveli i marrëzisë. Askund nuk e ka ndonjë këshillë se si të ekonomizojmë, si ta ruajmë ambientin, si ta mbjellim tokën, si të ndërtojmë fabrika, spitale, biblioteka, rrugë dhe infrastrukturë civilizuese. Shikoni si asgjësohet toka e bukës në vijën Prishtinë-Ferizaj. Po kush ka mund të ndërtojë aty para viti 1989. Jo, jo është dashtë Kosova me zemër disi, pa u zbuluar atdhetaria dhe dëlirësia nga okupatori perfid dhe meskin jugosllav komunisto - vetëqeverisës. Por, e tha ky dhe e mbaroi ai, po qeveriset sot. Fjalë boshe pa asnjë përmajtje. E gjeneratat e këtij kombi kanë investuar në këtë sovranitet të kufizuar, të cilin jemi kah punojmë për ta mos merituar sepse përçarjet bartin andej Kosovën martire. Pikërisht kah e dëshiron ish- okupatori dhe tani ish-pushteti që dikton, po ndodhë ky realitet i komprometimit që po jeton me mos durim totalitar. Dhe pse të kemi bisedime politike me Serbinë. Në cilin vend që ka ngjarë një praktikë e gjenocidit është dashtë kohë të sanohen plagët. Neve, dikush po përpiket që të na

"pjekë si bananet në prush". Kush po i drejton "teknikisht" këto bisedime, vlera e UÇK-së, e shtrun këtë pyetje për objektivizim. Si erdhi praktika nga bisedimet teknike të kalohet në bisedime politike, madje të nënshkruhet një Dokument Ndërkombëtar e të bëhen 23 shkelje të Kushtetutës, e të thuhet se çdo gjë është në rregull. Jo, more, ka zot, kjo tokë. Sivjet është komunikuar publikisht se Akademisë i dedikohen 2 milionë e sa buxhet. Për çka dhe ku shkojnë ato mjete. Për shkencë nuk dihet fare se çfarë rreshtimi do të ketë. Botimi i rezultateve shkencore është kah luftohet prej atyre që janë mësuar me dekada të jetojnë si parazitë. Deri kur dhe kush po i toleron dhe po i përkrahë hajnitë që janë bërë në Agjencinë e Privatizimit. Çka po ndodhë me universitetin që ia dridhi themelet Jugosllavisë titiste, është turp për atë staf arsimtarësh ta sjellin në këtë gjendje, që çdo tre muaj të ndërrohen rektorët, pale derisa të u rriten dikujt fëmijët e ta marrin atë timon. Kështu po del rezultati. Pse moralizohet dhe këto ditë se do të gjendet dhe do të publikohet emrat e uzurpatorëve. Pse asnjë mjet i informimit nuk i publikoi ata 170 sa u tha. Kjo është "njëqind arusha në mal...." Pse nuk publikohen nëpër mjetet të informimit se si janë uzurpuar pozitat nëpër Akademi, institute, katedra, ish uzina shoqërore, etj. Deri kurdo të i "qajmë të vdekurit" me qëllim që të mbulohen hajnitë e të gjallëve. Larg ka shkuar kjo valle e keqe që ma nuk mund të tolerohet. Pse i gjithë ky tetarizim kur nuk na duhet. Sot jepen lloj-lloj prognozash se si të dilet nga kriza. Taborët më të mëdha janë pozita pushtetare që thonë dhe provokohen se nuk luajmë prej "istikameve (foteleve-hb) pa vlue gjaku". Kështu mund të përkthehet kokëfortësia e tyre që e kanë shkelë 23 herë kushtetutën për hatër të ish- okupatorit. Në këtë rrafsh poliglot gabimesh nuk dihet edhe sa

shkelje tjera mrizojnë nëpër prokurori dhe gjykata. Opozita në anën tjetër po mbushet gati një vit që pengon çdo "normalitet", të paktën në Kuvendin e Kosovës, për aprovuar ligje dhe për të marrë vendime për ndërtimin e mëtejshmë të shtetit. Në kohën e fundit si duket, bazuar në mitingun e fundit ka treguar kulturë civilizuese. Por prapë pozita ka dalë disi me kokëfortësi, madje edhe me ofendime dhe po tregon se kjo qeveri nuk do normalitet. Ka ngulur këmbë në stilin o krejt, o hiq të gjithë. Pozicion shumë profitabil për ta, sa të jenë në fron, por mjerim për popullin që e sundojnë dhe nuk e drejtojnë kah duhet por drejtë humnerës, sepse opozita si duket nuk do të pushojë me metodat e saj "skajshmërisht destruktive", sidomos në parlament. Çka nëse mbahen zgjedhjet dhe prapë fitojnë këta të dhunshmit. A do ta pranoni verdiktin apo do të gjeneroni anarki të re, sepse forma të anarkisë ka mjaftë, madje dhe deri e tash kemi depozituar për eksport. Uluni e bisedoni ore të tërë sa nuk ju ka marrë dikush për veshi e të ju ulë në tavolina. Atëherë do të bëheni si qengja sepse ata do të ju thonë: "E keni sovranitetin e kufizuar, më tepër nuk meritoni". Ky është falli i politikës suaj triumfaliste, që mendoni se i dini të gjitha. E keni sjellë vendin buzë luftës civile. Këtë po e klithin shumë mediume me të drejtë. Kriza e përgjithshme e ka përfshi Kosovën. Shkencërisht është hulumtuar se ky mentalitet e shpërfilljes së rendit dhe ligjeve ka ardhur nga arroganca e ndërkombëtarëve, plus destruktiviteti i vendorëve që vetëm kanë bërë amën. Prandaj është e pamundur pa një operacion të dhimbshëm me ia kthe bazës normalitetin që këtu të investohet dhe vendi ekonomisht të prosperojë. Do të duhen ekipe ekspertësh të gjinden në vendet drejtuese, sepse mjaftë me poste politike që po dëshmojnë injorancë. Shikoni ministrat çfarë profesione kanë dhe çfarë funksioni kanë. (Vijon)



Tusk: Ballkani s'është lojë gjeopolitike shahu

BRUKSEL, 15 MAJ - Samiti i Sofjes për presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk, është vendi i duhur për "bashkimin" e Evropës jo thjesht sepse aty do të ulen në një tryezë të rrumbullakët diskutimesh liderët e BE-së dhe ata të Ballkanit Perëndimor, por sepse takimi mes tyre shihet si momenti ku të mëdhenjtë do t'i tregojnë Shqipërisë me shokë se vendi i tyre është në gjirin e unionit dhe jo në bashkëpunime me faktorë që tentojnë të ndërhyjnë në raporte gjeopolitike duke i transformuar ato.

Tusk është i bindur se Ballkani Perëndimor e ka vendin brenda

Bashkimit Evropian dhe në një pasazh të një letre, dërguar anëtarëve të Këshillit Evropian para samitit jetik të Sofjes, thekson se BE-ja është dhe do të mbetet partnerja e vetme që kujdeset vërtet për stabilitetin e të gjithë rajonit. Duke reflektuar nga përshtypjet e përfuara nga turi i vizitave në Ballkanin Perëndimor, Tusk jep një mesazh të fortë për BE-në, kur i kërkon ta trajtojë rajonin dhe çështjen e integritetit në tërësi siç duhet dhe jo thjesht si një lojë gjeopolitike shahu, ku njerëzit janë gurët. "Në ditët e ardhshme ne do të takohemi me partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor, për herë të parë të

gjithë bashkë pas 15 vjetësh. Pas udhëtimit tim të fundit në rajon, jam i bindur se BE-ja është partnerja e vetme që kujdeset vërtet për stabilitetin e të gjithë rajonit dhe për një të ardhme të begatë për popujt e saj, në krahasim me trajtimin e kësaj çështje si një lojë gjeopolitike shahu, ku njerëzit janë gurët. Perspektiva evropiane për Ballkanin Perëndimor mbetet një angazhim i vendosur nga të dyja palët. Por, pavarësisht nga deklaratat politike për të ardhmen, ne duhet të tregojmë se kujdesemi për zhvillimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor këtu dhe tani", thuhet në letrën e Tuskut.



Reagime për hapjen e Ambasadës Amerikane në Jerusalem

Shumë vende aleate me Shtetet e Bashkuara, sikurse edhe vende armike, po shprehin kritika ndaj vendimit të Uashingtonit për hapjen e Ambasadës Amerikane të hënën në Jerusalem, duke thënë se ky veprim ka për t'i rritur tensionet në Lindjen e Mesme.

NYU JORK, 15 MAJ - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka mbajtur të martën një takim urgjent për të diskutuar mbi situatën në Gazë, pas një dite me dhunën më vdekjeprurëse në mes të Izraelit dhe palestinezëve në pesë vjetet e fundit. Koordinator i posaçëm i OKB-së për procesin e paqes në Lindjen e Mesme, Nickolay Mladenov, pritet ta informojë Këshillin nga Jerusalemi. Kuvajti ka hartuar një deklaratë, ku shprehet "zemërim

i thellë dhe dëshpërim" për vrasjen e dhjetëra palestinezëve nga trupat izraelite, ndërsa bëhet thirrje për një hetim të pavarur. Diplomati në Kombet e Bashkuara thanë se ShBA-ja, aleate e Izraelit dhe një prej pesë vendeve anëtare të Këshillit me të drejtë vetoje, e bllokoi deklaratën. Presidenti francez Emmanuel Macron e dënoi dhunën në Gazë, ku ushtarët izraelitë vranë mbi 50 civilë palestinezë në përlëshjet e zhvilluara në kufi.



Përmes një deklaratë zyra e presidentit Macron tha se të martën ai ka në plan të flasë me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu. Shumë vende aleate me Shtetet e Bashkuara, sikurse edhe vende

armike, po shprehin kritika ndaj vendimit të Uashingtonit për hapjen e Ambasadës Amerikane të hënën në Jerusalem, duke thënë se ky veprim ka për t'i rritur tensionet në Lindjen e Mesme. Edhe kryeministrja britanike


Theresa May nuk ishte dakord me hapjen e Ambasadës Amerikane në Jerusalem para se të arrihej një marrëveshje përfundimtare paqeje në Lindjen e Mesme.

Ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov përsëriti kundërshtimin e Moskës për hapjen e Ambasadës Amerikane në Jerusalem.

Një numër i madh udhëheqësish të vendeve arabe e dënuan këtë veprim: kryeministri libanez Saad Hariri e cilësoi atë një veprim "provokues", ndërsa ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif tha se e hëna ishte "një ditë turpi". Qeveria turke tha se do ta thërriste ambasadorin e vet në Shtetet e Bashkuara "për konsultime" lidhur me veprimin e hapjes së ambasadës.

Putini merr pjesë në hapjen e urës që lidh Rusinë me Krimenë

MOSKË, 15 MAJ - Presidenti rus, Vladimir Putin, pritët të marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së një prej projekteve të tij më prestigjioze, urës kontroverze që lidh Krimenë e aneksuar me Rusinë. Ura 19 kilometra që kalon në Ngushticën Kerç ishte planifikuar të funksionalizohej në dhjetor të vitit 2018, mirëpo autoritetet ruse kanë njoftuar se ajo që Moskë e cilëson Ura e Krimesë do të jetë e gatshme për qarkullim më 16 maj. Punimet në këtë urë kanë për-



funduar më 2016, dy vjet pasi Rusia ka fituar kontrollin në Krime. Putini ka thënë se ura do ta integrojë Krimenë në sistemin e transportit të Rusisë dhe do të krijojë mundësi për rritje ekonomike.

Qeveria e Putinit ka aneksuar Krimenë në mars të vitit 2014, pasi presidenti ukrainas, i afërt me Moskën, Viktor Yanukovich, është larguar nga pushteti pas disa muaj protestash në rrugë.

Kundëramerikani al-Sadr prin në zgjedhjet në Irak

BAGDAD, 15 MAJ - Në Irak koalicioni i udhëhequr nga kleriku shiit kundëramerikan Muqtada al-Sadr duket se po del fitues në zgjedhjet parlamentare të së shtunës. Ndërsa janë numëruar thuajse shumica e votave, Aleanca Marshimi drejt Reformave e al-Sadrit udhëheq në gjashtë rajone, e pasuar nga grupi i kryesuar nga komandanti i milicisë irakiane Hadi al-Amiri.



Kryeministri aktual Haider al-Abadi, i cili ka mbështetur në ShBA-së, është në vend të tretë. Ai u ka bërë thirrje irakianëve ta respektojnë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Al-Sadri nuk kandidoi për një vend në Parlament, prandaj nuk mund të

bëhet kryeministër i vendit. Por, si kreu i një aleance politike ai ka për të luajtur rol të rëndësishëm për arritjen e një marrëveshjeje për formimin e Qeverisë irakiane.

Zarifi viziton Brukselin në përpjekje për ta shpëtuar paktin bërthamor


TEHERAN, 15 MAJ - Ministri i Jashtëm i Iranit, Mohammad Javad Zarif, do ta vizitojë Brukselin në kuadër të turneut të tij botëror, për të kërkuar mbështetje për marrëveshjen bërthamore të vitit 2015, në mes të Teheranit dhe gjashtë fuqive botërore. Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar se janë tërhequr

nga marrëveshja e cila është nënshkruar në mes të Iranit, Rusisë, Kinës, Britanisë, Francës dhe Gjermanisë. Zarifi do të takohet me shefen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini dhe me homologët nga Britania, Franca dhe Gjermania, në përpjekje për ta shpëtuar marrëveshjen, e cila i

mundëson Teheranit lehtësim të sanksioneve në këmbim të frenimit të programit bërthamor. ShBA-ja ka akuzuar Iranin se ka shkelur marrëveshjen duke vazhduar testet e raketave balistike dhe mbështetjen e militantëve në Lindjen e Mesme. Irani ka theksuar se programi bërthamor ka qëllime paqësore.



JAKOV XOKA, KRIJUES I MADH I LETËRSISË SHQIPE



REXHEP QOSJA

Shkrimtarët e mirë, të dalluar e të shquar, me dhunti të madhe krijuese, nuk dëshirojnë t'i shëmbëllojnë njëri-tjetrit.

Jakov Xoxa ishte shkrimtar i tillë. Kjo cilësi e tij është arsyeja pse ai mund të quhet shkrimtar i veçantë.

Ai është shkrimtar i veçantë për temat që trajton, për mënyrën si i trajton ato tema, për gjuhën dhe stilin e tij, dhe për thellësinë psikologjike të krijimtarisë së tij, në mënyrë të veçantë të romaneve të tij.

Jakov Xoxa nuk ka trajtuar tema të mëdha historike si, për shembull, tema nga koha e Skënderbeut apo nga koha e Ali Pashë Tepelenës.

Ai s'e ka trajtuar as temën e madhe të ballafaqimit të popullit shqiptar me popuj të tjerë.

Jakov Xoxa ka trajtuar tema të zakonshme, por këto tema të zakonshme në krijimtarinë e tij i ka bërë të jashtëzakonshme me dhuntinë e tij, me shprehjen e tij, me stilin e tij.

Këto tema të zakonshme në veprat e tij ai i ka bërë pararendëse, parathënëse të kohëve historike në jetën e popullit shqiptar.

Jakov Xoxa dallon prej shkrimtarëve të tjerë edhe me personazhet dhe me protagonistët e veprave të tij. Ai ka trajtuar personazhe të të gjitha shtresave shoqërore, të të gjitha profesioneve, të të gjitha forcave shoqërore, kur e kur edhe personazhe politike. Jakov Xoxa cilësohet shkrimtar i veçantë edhe për sistemin e motivacionit në krijimtarinë e tij. Te shumë shkrimtarë të shekullit të njëzetë sistemi i motivacionit është i thjeshtë e i njëanshëm; zakonisht ata marrin një aspekt jetësor që kushtëzon veprimet, sjelljet, mendimet, ndjenjat e personazheve në veprat e tyre letrare.

Te Jakov Xoxa personazhet mendojnë, veprojnë e sillen të nxitur nga motive psikologjike, sociale, morale, kombëtare, historike, kur e kur edhe politike. Jakov Xoxa është shkrimtar i veçantë dhe me mitologjinë politike të përmbajtur në romanet e tij.

Në to ai trajton doke, zakone, venome popullore.

Trajton mentalitetin fisnor.

Trajton, ndjenjat, pakënaqësinë, dhembjen, skamjen e popullit të pushtuar prej institucioneve politike e shoqërore. Dhe, të

gjitha këto tema, ndjenja, tradita në veprat e tij bëhen elemente të mitologjisë politike. Në të vërtetë, të gjitha këto janë gjuha me të cilën protagonistët e tij flasin, gjuha me të cilën qenia kombëtare shqiptare e flet historinë e vet.

Jakov Xoxa është shkrimtar i veçantë edhe për ironinë e përdorur në romanet e tij. Shumë shkrimtarë të shquar i shmangen retorikës dhe i shmangen retorikës duke përdorur ironinë.

Te Jakov Xoxa ironia ka një kuptim shumë më të thellë. Personazhet që kryejnë veprime të kushtëzuara prej leverdive, interesave, hesapeve të ndryshme në jetë, Jakov Xoxa i ndëshkon me ironinë e tij letrare. Për shkak të atyre interesave, ata nuk gjejnë rrugëdalje nga kundërtënia me të cilat jetojnë dhe për këtë arsye ndëshkohen agai, begu, pronari i tokave, feudali, intelektual moralisht i dyshimtë. E të tjerë.

Edhe për sa i përket trajtimit të anëve, ndjenjave, mendimeve, përjetimeve, aspekteve të tërësisë jetësore, Jakov Xoxa është krijues i veçantë në letërsinë shqipe.

Në veprat e tij do të gjejmë pasjen dhe skamjen; do ta gjejmë lindjen, rritjen, pleqërinë dhe vdekjen; do ta gjejmë dashurinë dhe urrejtjen; do të gjejmë solidarësi dhe mënjani; do të gjejmë ngritje dhe dështim; do të gjejmë fitore dhe disfatë; do të gjejmë përjetime të ndryshme të njerëzve në jetë.

Domethënë: nuk ka aspekt, nuk ka anë, nuk ka ndjenja, nuk ka përjetime të njeriut të cilat nuk mund t'i gjejmë në veprat e Jakov Xoxës.

Në romanet e Jakov Xoxës do të gjejmë edhe atë që e quajmë folklori popullor, krijimtari shpirtërore e popullit tonë: do të gjejmë legendën, do të gjejmë përrallën, do të gjejmë anekdotën; do të gjejmë krijime të tjera të ndryshme popullore.

Dhe të gjitha këto do t'i gjejmë ashtu siç i gjejmë në veprat e autorëve modernë, jo për të qenë aty, jo për folklor e folklorizim, por i gjejmë për një kuptim, për një domethënie, për një qëllim shumë krijues.

Ato e pasurojnë, e thellojnë dhe e zgjerojnë semantikisht e emocionalisht veprën e tij. Ato krijime popullore kanë një funksion krijues estetik dhe semantik shumë të rëndësishëm në krijimtarinë e Jakov Xoxës.

Jakov Xoxa është krijues i veçantë në letërsinë shqipe edhe me fatin e tij në kritikën dhe në historinë e letërsisë shqipe.

Unë, natyrisht, nuk mund ta di sa krejt është shkruar për Jakov Xoxën, por e di se sa krejt do të

duhej të ishte shkruar për të. Supozoj se mund të jenë tri, katër, pesë monografi të shkruara për të, por ne sot kemi shumë monografi doktoratash për shumë shkrimtarë të tjerë, për shkrimtarë që unë, si studiues i letërsisë shqipe, nuk i krahasoj me Jakov Xoxën.

Mendoj me keqardhje se ky shkrimtar nuk ka gëzuar përkushtimin që meriton dhuntia e tij shumë e frytshme në letërsinë shqipe dhe, rrjedhimisht, në historinë e saj. Mund të shtoj, ndërkaq, se veprën më të mirë për të, për gjuhën dhe stilin e tij dhe në përgjithësi për veprën e tij e ka shkruar studiuesja Shefkije Islamaj; e ka shkruar një vepër të madhe me vëllim dhe një vepër të madhe me kuptimin, me domethënie dhe me vlerën e saj. Dhe, një monografi të madhe për një shkrimtar të veçantë, të madh mund të shkruajë vetëm një studiuese me dhunti të madhe krijuese shkencore.

Androkli Kostallari, drejtor i dikurshëm i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, thoshte: "Dy shkrimtarët që kanë gjuhën më të pasur, që përdorin më së shumti leksik, janë Dhimitër Shuteriqi, i cili përdor deri në 11 000 fjalë dhe Jakov Xoxa, i cili përdor deri në 12 000 fjalë".

Këto pohime i përkasin kohës, kur ende nuk ishin botuar "Lulja e kripës", tani e titulluar "Lulet e kripës", e cila e pasuron edhe më tepër fondin e fjalëve që ka përdorur Jakov Xoxa, i cili, po e përsëris edhe një herë, dallohet për leksikun jashtëzakonisht të pasur në krijimtarinë e tij letrare, në të vërtetë në historinë e letërsisë shqipe në përgjithësi.

Androkli Kostallari thoshte se shkrimtarët e tjerë shqiptarë përdorin deri në 5 000 fjalë, kurse për në Kosovë thoshte se shkrimtarët përdornin atëherë deri në 3 000 fjalë. Bëhet fjalë për vitet '70. Unë besoj se kjo ishte e vërtetë, sepse pohimet e Androkli Kostallarit bazoheshin në studimet që bëheshin në Institutin e Gjuhës dhe të Letërsisë në Tiranë.

Unë kam pasur fatin ta takoj Jakov Xoxën dy herë. Kujtoj se herën e parë e kam takuar në vitin 1970, kur mua më ishte dhënë leja, më ishte dhënë viza, që të punoja në Tiranë për doktoratën, që e kisha paraqitur në Prishtinë për Asdrenin. Do të punoja në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin e Shtetit.

Atëherë, në vitin 1967, unë kisha shkruar një trajtesë për "Lumin e vdekur". Dhe këtë trajtesë e kisha botuar në numrin e dytë të revistës "Jeta e re" më 1968. Ai numër i "Jetës së re" i kishte rënë në dorë Jakov Xoxës. Në atë kohë

ishin vendosur marrëdhënie midis Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit, të shkencës dhe të kulturës.

Ne në Kosovë kishin filluar të na çoheshin libra prej Shqipërie dhe në Shqipëri kishin filluar të çoheshin libra prej Kosovës.

Jakov Xoxa e kishte lexuar atë trajtesë timen që i kishte bërë përshtypje të mirë. Derisa isha në Tiranë, një ditë ai erdhi dhe më vizitoi në hotel "Dajti", në një zyrë të caktuar për biseda. Atëherë, bisedat midis shqiptarëve që vinin nga Kosova dhe shqiptarëve të Shqipërisë nuk shtriheshin gjerë. Kjo ishte e kuptueshme. Ne biseduam kryesisht për punën krijuese, për letërsinë, për romanet që botoheshin në Shqipëri e në Kosovë e që më pas këmbeshin dhe në fund të bisedës Jakov Xoxa më dhuroi romanin "Lumi i vdekur", në të cilin kishte një përkushtim shumë domethënës e të përzemërt. Në atë përkushtim ai përmendte emrat e Adilit dhe të Vitës, të cilët ishin protagonistët e romanit të tij. Adili kosovar dhe Vita myzeqare.

Në romanin e tij Jakov Xoxa kishte krijuar dashurinë midis këtyre dy të rinjve: kosovarit dhe myzeqares. Bukur apo jo.

Jakov Xoxa është i pari shkrimtar i letërsisë shqipe që në romanin

e vet e ka shndërruar në ideal dashurinë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, në mes të vajzës nga Shqipëria dhe djalit nga Kosova. Dhe, kështu, ai është krijuesi, intelektual ynë i parë që ka ngritur lart idealin e bashkimit të Shqipërisë me Kosovën.


Te Jakov Xoxa unë kam parë, kam kuptuar, kam çmuar një dhunti të veçantë, të madhe, krijuese: dhuntinë më të madhe krijuese të një shkrimtari shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore.

Pse them kështu?

Them kështu sepse "Lumin e vdekur", "Lulet e kripës" dhe "Jugën e bardhë" ka mundur t'i shkruajë vetëm Jakov Xoxa; dhe i ka shkruar duke iu shmangur në masën më të madhe dogmës që sundonte atëherë në letërsinë shqipe: duke iu shmangur dogmës së realizmit socialist.

Pos një dhuntie të madhe, të një krijuesi të madh në historinë e letërsisë shqipe, Jakov Xoxa kishte edhe një karakter të fuqishëm dhe këtë e dëshmon jeta e tij, sjellja e tij në përgjithësi. Jakov Xoxa kishte bashkuar ashtu dy vlera të mëdha të një krijuesi, që janë: dhuntia e madhe dhe karakteri i fuqishëm.

(Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")



E rrallë**Ushtari mysliman i mbushur me tatuazhe**


Një ushtar nga Sidnej, i cili e quan veten "ushtari mysliman", e ka mbushur trupin e tij muskulator me tatuazhe, edhe pse feja nuk ia lejon këtë gjë. I njohur në "Instagram" si Yakiboy, ushtari ka 53 300 ndjekës në rrjetin social, aty ku poston foto nudo, për të treguar se nuk ka më hapësirë në trupin e tij për tatuazhe të reja.

**FOTO E DITES**

Turma e biçikletave kalon përgjatë një fushe me lule në kuadër të turneut të 101 "Tour of Italy cycling race" në Itali.
/AFP, publikuar nga VOA/

E jashtëzakonshme**Thyhet xhami i kabinës së avionit, temperatura -40 gradë**

Një aksident i pazakontë i ka ndodhur një avioni, i cili ka bërë ulje të detyruar në Kinë. Xhami i kapinës së avionit është thyer në një lartësi prej 10 mijë metrash, ndërsa edhe pse temperatura në kabinë ka shkuar deri në -40 gradë celsius, piloti ka arritur ta ulë avionin.

**BARSOLETA E DITËS****Vdekja**

- Shpresoj të vdes në gjumë si gjyshi im.
- Pse në gjumë?
- Po më mirë të vdesësh në gjumë sesa duke bërë titur, siç vdiqën pasagjerët e tij!

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.


**DASHI**

Initiativat që ndërmerrni shumë herë

varen nga pasioni me të cilin i përballoni. Këto të fundit do të rezultojnë shumë fitimprurëse për ju.

**DEMI**

Falë Marsit në shenjën tuaj jeni mjaft determinues dhe të gatshëm ta mbron çdo ide tuajën pa asnjë hezitim.

**BINJAKËT**

Këqkuptimet në shumë drejtime po krijojnë mjaft tension në jetën tuaj. Duhet të filloni ta menaxhoni stresin dhe të tregoheni më të qetë me të tjerët.

**GAFORRJA**

Nëse ju duhet të përballoni një debat

me një person të rëndësishëm sot, mundohuni të mos udhëhiqeni nga emocionet, por arsyetoni qetësisht.

**LUANI**

Sot do të bini pre e nervozizmit dhe

do të prishni gjithçka që keni ndërtuar me aq mund deri tani. Në familje situatat nuk paraqiten dhe aq të qeta.

**VIRGJËRËSHA**

Merkuri në shenjën bën që të jeni mjaft

të predispozuar për marrëveshje të reja biznesi që do të sjellin përfitime të mira.

**PESHORJA**

Do të jeni shumë intuitiv sot dhe sigurinë

tuaja të brendshme do të sjellin mjaft qetësi shpirtërore. Ju ka kapur një fazë e qetë në jetën tuaj.

**AKREPI**

Të falesh dikë që ka gabuar pa dashje është shumë më e lehtë se t'i drejtosh gishtin për gabimin e kryer. Do të arrini të neutralizoni një problem.

**SHIGJETARI**

Edhe pse sot ndiheni nervoz me partnerin do të arrini ta toleroni në një problem të përbashkët. Gjërat nuk janë më si më parë mes ju të dyve.

**BRICJAPI**

Sot do t'i përkush-toheni totalisht mbremjes sepse një takim i rëndësishëm mund të vendos fatet e jetës suaj.

**UJORI**

Këtë periudhë favorizohen flirtet e

reja, por ndërkohë po kaloni një zhgënjim që do t'ju lë gjurmë për pak kohë.

**PESHQIT**

Ndiheni mjaft vital në këtë periudhë

dhe po angazhoheni në mirëqenien tuaj fizike. Do të keni përfitime materiale në një projekt të caktuar.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BRABRAND - ROSKILDE

2

BRANN - HAUGESUND

GG3+

ROSENBORG - LILLESTROM

GG3+

Prishtina - Drita nuk zhvillohet në kryeqytet. Akuzohet dhe kërcënohet Vokri

MKRS-ja ka marrë vendim final që ndeshja në mes të Prishtinës dhe Dritës mos të zhvillohet në kryeqytet, me arsyetimin se lejimi i zhvillimit të ndeshjes pa u pranuar teknikisht stadiumi i Prishtinës dëmton në tërësi projektin dhe investimin. Pas këtij vendimi ka reaguar FC Prishtina, e cila e akuzon kryetarin e FFK-së, Fadil Vokrin, kurse "Plisat" i kanë kërcënuar kryetarin dhe zëvendëssekretarin e FFK-së



Orari për ndeshjet e fundit në Superligë dhe Ligën e Parë

VALA SUPERLIGA

Të premtën takohen:
Trepça '89 - Vllaznia
Besa - Llapi
Flamurtari - Feronikeli

Të shtunën takohen:
Vëllaznimi - Gjilani
Drenica - Liria

Të dielën takohen:
Prishtina - Drita

LIGA E PARË

Të premtën takohen:
Kosova (P) - Vushtrria
Të shtunën takohen:
Onix - Dukagjini
KEK-u - Ramiz Sadiku
Ballkani - Trepça
Rahoveci - Z. Korriku
Bashkimi - Ferizaj
Kika - Fushë-Kosova
Hajvalia - Vitia

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 MAJ - Ndeshja e fundit derbi në mes të Prishtinës dhe Dritës, e cila do të vendosë edhe titullin e kampiones në futboll për edicionin 2017/2018, nuk do të zhvillohet në stadiumin e Prishtinës. Këtë vendim e ka marrë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), duke vlerësuar se lejimi i zhvillimit të ndeshjes pa u pranuar teknikisht stadiumi i Prishtinës dëmton në tërësi projektin dhe investimin. "Pas kërkesës që ka parashtruar FC Prishtina dhe Komuna e Prishtinës për lejimin e zhvillimit të ndeshjes në mes të Prishtinës dhe Klubit të Futbollit Drita nga Gjilani, përfaqësues të MKRS-së, komunës së Prishtinës, Federatës së Futbollit të Kosovës, të FC Prishtinës dhe punëkryesit janë takuar në stadium për ta analizuar në vend të ngjarjes kërkesën dhe

situatën e re të krijuar. Siç është bërë me dije për opinionin, MKRS-ja ka vepruar sipas rekomandimeve të UEFA-së, ku ka proceduar njoftimin e kontratës së negociuar me qëllim të realizimit të projektit që do të përfundojë më 30 qershor 2018, kontratë e cila ka përcaktuar planin dinamik me punëkryesin. Para kësaj date lejimi i zhvillimit të çfarëdo ndeshjeje shkel kushtet e kontratës dhe përbën shkelje ligjore dhe dëmton procesin në përgjithësi. Prandaj, si MKRS nuk jemi të interesuar as ta dëmtojmë investimin që kemi bërë në stadiumin e Prishtinës dhe as nuk duam të marrim ndonjë dënim eventual edhe nga UEFA", thuhet në një njoftim të MKRS-së.

Pas vendimit që ndeshja kryesore e këtij edicioni të mos zhvillohet në kryeqytet, Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka njoftuar se në muajin e ardhshëm do të vijë për inspektorët e UEFA-s. "Në pjesën e

parë të muajit qershor do të vijnë inspektorët e UEFA-s, Mark Blackburne e Marshall Nicolaus, të cilët do ta shohin nivelin dhe shkallën e kryerjes së punimeve në stadium dhe eventualisht do t'i japin mendimet e tyre për ndonjë vërejtje eventuale", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Pas këtij vendimi ka reaguar skuadra e Prishtinës, e cila e akuzon kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrin, lidhur me ndikimin që ka ushtruar që të merret ky vendim.

FC Prishtina këtë vendim e vlerëson si një fitore të radhës të kryetarit të FFK-së, Fadil Vokri, kundër Prishtinës. "Edhe një fitore e Fadil Vokrit kundër Prishtinës. Nuk mbi-zotëroi arsyeja, edhe pse të gjithë përgjegjësit ishin për t'u zhvilluar ndeshja në stadiumin e qytetit. Por, ishte Vokri që me presion të paparë

e të padëgjuar, duke mos fjetur tërë natën e, mbase, duke qëndruar te 'Bata' në Graçanicë, nuk la birë pa thirrur, për ta arritur qëllimin, duke penguar të zhvillohet ndeshja në stadiumin tonë. Dikur jetonte me ndihma në Francë, pastaj drejtori i klubit me 3 000 euro rrogë, sot fuqishëm e paturpësisht e luftoi klubin që e kaliti, klubin që e ktheu në vendlindje, duke e amnistuar nga ngjarjet që opinioni kurrë nuk do t'ia harrojë gjatë viteve '90. Ai sot manipuloi tërë institucionet, por jo edhe opinionin publik, jo me adhuruesit tanë, jo edhe banorët e qytetit. Prishtina është më e madhe se çdo individ", thuhet në reagimin e FC Prishtinës.

Ndërsa tifozët e Prishtinës, "Plisat", e kanë kërcënuar kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrin dhe zëvendëssekretarin e FFK-së,

Arianit Ahmeti. "Fadil Vokri, ty që ai Flamur Bunjaku, nënkryetari i Dritës, të shëtitë nëpër Meksikë, e ti Arianit Ahmeti që Astrit Haraqia ta ka shpikur atë post, dijeni se: Ose do të luajmë në stadiumin tonë, ose ju kenë me u shpërngul prej Prishtinës. Nuk kanë me ju ekzistuar më as zyrrat", thuhet në reagimin e "Plisave".

Sonte vendoset 'mbreti' në Ligën e Evropës



FORMACIONET E MUNDSHME

Marseille: Pele, Sarr, Rami, Gustavo, Amavi, Lopez, Sanson, Thauvin, Ocampos, Payet, Germain.

FORMACIONET E MUNDSHME

Atletico Madrid: Oblak, Juanfran, Godin, Saviq, Luis, Correa, Gabi, Saul, Koke, Costa, Griezmann.

LYON, 15 MAJ - Skuadra që do të shpallet fituese e Ligës së Evropës do të vendoset sonte (e mërkurë), kur do të përballen dy skuadrat më të mira të këtij edicioni në Evropa Ligë, Marseille dhe Atletico Madrid. Në fundjavë skuadra e Marseillet u ndal në barazim nga Guingamp (3-3) në kuadër të kampionatit francez dhe konfirmoi edhe një herë se ka probleme në repartin e mbrojtjes duke pranuar shumë gola. Ndërsa Atletico arriti fitore ndaj Getafës (0-1) dhe vendimtar në këtë fitore ishte portieri Jan Oblak, i cili ndali një penallti. Skuadra spanjolle edhe në këtë ndeshje

sikurse në të tjerat dëshmoi se është në gjendje të shënojë fitore me rezultat të ngushtë, duke mos pranuar shumë gola. Marseille pasi kaloi fazën e grupeve i ka eliminuar Bragën, Athletic Bilbao, Rasen Ballsport Leipzigun dhe Salzburgun e Valon Berishës, ndërsa Atletico, për të arritur deri në finale, eliminoi këto skuadra: Koebenhavn, Lokomotiv Moscow, Sporting dhe favoritin e madh Arsenal. Mungesa të futbollistëve tek asnjëra skuadër nuk do të ketë, kurse skuadrës spanjolle do t'i mungojë trajneri Diego Simeone, i cili është suspenduar.

Më 29 maj miqësorja Shqipëri - Kosovë

PRISHTINË, 15 MAJ - Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) ka njoftuar zyrtarisht për zhvillimin e ndeshjes miqësore të kombëtares kuqezi ndaj përfaqësueses së Kosovës. Kjo ndeshje do të zhvil-

lohet më 29 maj në Cyrih. Takimi do të luhet në stadiumin "Letzingrund" nga ora 20:00, kurse pak ditë më vonë është përcaktuar të luhet edhe një tjetër takim miqësor me përfaqësuesen

e Ukrainës.

Kombëtarja shqiptare e futbollit do ta nisë grumbullimin në Zvicër më 26 qershor për t'i përgatitur edhe këto dy sfida miqësore. Miqësoren e ka konfirmuar edhe

Federata e Futbollit të Kosovës, e cila bën me dije se, pas përpjekjeve të mëdha nga kryetari Fadil Vokri, Federata e Futbollit të Zvicrës është bindur për lejimin e kësaj ndeshje miqësore.



Përfundon aventura e Kones te Feronikeli

DRENAS, 15 MAJ - Ben Hamed Kone, i cili kishte ardhur me shumë bujë te Feronikeli në këtë dimër, do të largohet në fund të këtij sezoni. Feronikeli e ka konfirmuar se ai do ta vazhdojë karrierën në Zvicër. "Duke e falënderuar për kontributin e madh të dhënë dhe për energjinë

e treguar në fushë, klubi njofton se pas përfundimit të këtij kampionati Ben Hamed Kone nuk do të jetë më pjesë e Feronikelit. Për këta muaj sa qëndroi tek klubi ynë, ai u adaptua shumë lehtë me lojën dhe u familjarizua shumë shpejt me lojtarët, por aventura e tij në

klubin dhe shtetin tonë përfundon këtu. Ne e falënderojmë për atë që ka bërë për Feronikelin dhe i dëshirojmë fat në kampionatin zviceran, ku do ta vazhdojë karrierën e mëtutjeshme", thuhet në njoftim e KF Feronikeli.



Lowi fton Neuerin, 'harron' Gotzen dhe Mustafin



BERLIN, 15 MAJ - Trajneri i Kombëtares së Gjermanisë, Joachim Low, të martën e ka bërë publike listën paraprake me 35 futbollistët që mund të jenë të pranishëm në Botërorin e Rusisë. Një mungesë e madhe në listë është ajo e Mario Gotzes, i cili i dha Kupën e Botës Gjermanisë para katër vjetësh në Brazil, duke shënuar golin e fitores ndaj Argentinës vetëm pak minuta para fundit. Mungesa të tjera të rëndësishme janë ato të sulmuesit të Bayern Munchenit, Sandro Wagner dhe e mbrojtësit shqiptar Shkodran Mustafi. "Detyra ime si

trajner i kombëtares disa herë është edhe t'i prish ëndrrat. Unë nuk marr asnjëherë vendime kundër lojtarëve, por për skuadrën. Shpesh varet nga gjëra të vogla, por kriter i zgjedhjes

është cilësia atletike, që ka një rol qendror dhe që skuadra të jetë e bashkuar si në fushë, po ashtu edhe jashtë saj", ka thënë Joachim Low, pasi e zbardhi listën e futbollistëve.

Lista e lojtarëve

Bernd Leno, Manuel Neuer, Marc-Andre ter Stegen, Kevin Trap, Jerome Boateng, Matthias Ginter, Jonas Hector, Mats Hummels, Joshua Kimish, Marvin Platenhardt, Antonio Rudiger, Niklas Sule, Jonathan Tah, Julian Brandt, Julian Draxler, Leon Goretzka, Ilkay Gundogan, Sami Khedira, Toni Kroos, Mesut Ozil, Sebastian Rudi. Mario Gomez, Thomas Muller, Timo Werner, Nils Petersen, Marco Reus, Leroy Sane.

Golden State e fitoi finalen e parë ndaj Houstonit

OAKLAND, 15 MAJ - Golden State Warriors fitoi 119-106 ndaj Houston Rocketsit në finalen e parë të Konferencës së Perëndimit, duke udhëhequr 1-0 me ndeshje. Kampionët e NBA-së zhvilluan një ndeshje të mirë, duke qenë superiorë në fushën në shumicën e kohës, duke e merituar fitoren. Houstoni e nisi më mirë takimin, duke qenë në avantazh në periodën e parë, por miqtë rikuperojnë në çerekun e dytë, duke bërë që pjesa e parë të mbyllet në ekuilibër. Në pjesën e dytë erdhi shpëputja e ekipit mik, që mori frenat e lojës në dorë, duke dominuar në fushë. Duranti me 37 pikë ishte shënuesi më i



mirë për Golden Staten, mbështetur nga Thompsoni me 28 pikë e Curry me 18, një trio që bëri diferencën në parket. Në kahun tjetër, Hardeni realizoi 41

pikë, ndërsa Pauli realizoi 23 pikë e 11 rebaunde, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Edhe ndeshja e dytë do të luhet në fushën e Houstonit.

SHKURT

Mançini prezantohet trajner i Italisë

Roberto Mançini është trajneri i ri i kombëtares italiane. Ai nënshkroi me Federatën Italiane të Futbollit (FIGC) një kontratë dyvjeçare deri në vitin 2020, me një pagë prej dy milionë eurosh në vit, shifër kjo që është tri herë më e ulët nga ajo që përfitonte te Zeniti. "Ishte e lehtë për mua të zgjidhja. Jam krenar që do ta drejtoj kombëtaren. Për mua që kam qenë i grumbulluar në Coverciano që nga viti 1978, kur isha 14 vjeç, kjo është gjëja më e bukur. Jam i lumtur për këtë zgjedhje të bërë, edhe për prindërit e mi që ndihen krenarë. Në radhë të parë dua të jem një trajner i mirë dhe në gjendje ta kthej Italinë në pozicionin që i takon, në elitën e futbollit botëror dhe evropian", ka deklaruar Mançini. E reja në këtë pikë është përfshirja në stafin teknik të Andrea Pirllos, roli i të cilit nuk është përcaktuar ende. Mançini do ta bëjë debutimin më 28 maj në ndeshjen që Italia do ta luajë me Arabinë Saudite, ndërkohë që më 1 dhe 4 qershor "Të kaltrit" do të përballen me Francën e Holandën.

Abazi, anëtar i ri Bordit të FHK-së

Presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës (FHK), Eugen Saraçini, me qëllim të funksionalizimit të Bordit të FHK-së para sfidave të radhës, të cilat e presin në periudhën e ardhshme qoftë me kombëtares apo garat e klubeve, në bazë të kompetencave nga statuti i FHK-së, emëroi anëtarë të ri të Bordit të FHK-së me mandat dyvjeçar punëtorin e devotshëm sportiv, afaristin e njohur ferizajas Lulzim Abazi. Ky i fundit edhe më herët ka qenë anëtar i Bordit të FHK-së në periudhën 2005-2010, kurse nga viti 2002 dhe deri më sot ishte në krye të Kastriotit me një pauzë dyvjeçare, dhe kontributi i tij në sukseset e KH Kastrioti ishte i madh.

Guardiola e kërkon Kroosin te City

Pep Guardiola dëshiron të bashkohet sërish me mesfushorin e Real Madridit, Toni Kroos. Sipas medieve spanjolle, Kroosi qëndron në majën e dëshirave të teknikut të kampionëve të Premierë Ligës për afatin kalimtar veror. Ish-mesfushori i Bayern Munchenit është një objektivi edhe i Jose Mourinhos te Manchester Unitedi, por Guardiola nuk dëshiron ta humbasë mundësinë për të punuar me të përsëri.

Ilniesta: Jam në mes të Kinës dhe Japonisë

Andres Iniesta ende nuk ka vendosur se ku do ta vazhdojë karrierën pas largimit nga Barcelona. Ylli spanjoll ka bërë me dije se është në mes të Kinës dhe Japonisë. "Kinë ose Japoni, dhe secila prej tyre ka avantazhet. Ka disa detaje të vogla që nuk janë përcaktuar ende dhe bashkë me menaxherin tim po mendojmë ta zgjedhim alternativën më të mirë. Javën e ardhshme do të vendos për të ardhmen", ka thënë Iniesta.

Icardi nuk largohet nga Interi

Drejtori Sportiv i Interit, Piero Ausilio, ka siguruar se sulmuesi Mauro Icardi nuk do të shitet, pavarësisht se a luan Interi në Ligën e Kampionëve apo në Ligën e Evropës. "Zikaltrit" duhet patjetër ta mposhtin Lazion të dielën për t'u kualifikuar në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kampionëve. "Mauro ka kontratë trevjeçare me Interin. Gjithmonë kam thënë se kjo situatë nuk do të ndryshojë për shkak të pozitës në ligë. Arrija e pozitës së katërt apo të pestë natyrisht se do të ndryshonte diçka për ne, por jo edhe dëshirën tonë për të vazhduar me kapitenin tonë. Icardi qëndron, nuk kemi për qëllim ta shesim. Ai ka klauzolë, e cila e ka një afat skadues dhe është e vlefshme vetëm për klubet jashtë Italisë", ka thënë Ausilio.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Arsimit

Nr. 12-3480 /2018
Klinë, 15/05/2018

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.72/2010), nenit 34, paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04/L-032, nenit 5, pika C e Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 2, pika 2 e UA nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

KONKURS PUBLIK PËR

Drejtore të institucioneve edukativo-arsimore.

- SHFMU "Ismet Raci Kline, numër reference: JP00032983

Koeficienti i pagës: 7.8

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit shkollor,
- Hartimin e planeve vjetore të punës dhe planin zhvillimor të shkollës,
- Koordinimi i punës me Këshillin e shkollës, aktivet profesionale dhe organet tjera qeverisë në shkollë,
- Detyrat dhe obligimet që dalin në bazë të plan programit mësimor aktual,
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave ashtu si parashihet në Ligjin e arsimit dhe në aktet normative,
- Monitorimin e orëve mësimore,
- Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ dhe teknik,
- Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimi sipas kërkesave,
- Ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe llogaridhënia për shpenzimet buxhetore,
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë,
- Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës,
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte të tjera normative.

Për të gjitha pozitat:

Mbikëqyrësi: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Orari i punës: 40 orë
Kohëzgjatja e Emërimit: Emërimi është me mandat 4 vjeçar.

Shkollimi i kërkuar për pozitën e kërkuar:

- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor 4 vjeçar, 240 ECTS.
- Të kenë diplomë Universitare nga profilet arsimore të pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe sipas normativit për Kuadrin mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të ketë licencë të rregullt për mësimdhënie ose të jenë në përfundim të procedurës së licencimit.
- Përvoja, aftësitë dhe cilësitë e tjera:
- Së paku tri (3) vite përvojë pune në arsim.
- Të kenë të përfunduar me sukses një nga programet e akredituara të kualifikimeve profesionale për udhëheqje, administrim ose menaxhim të institucioneve edukativo-arsimore.
- Njohuri lidhur me ligjet, rregulloret e aplikueshme në fushën e arsimit dhe njohuritë lidhur me dokumentacionin shkollor dhe pedagogjik të nxënësve,
- Shkathtësi në komunikim, planifikim dhe koordinim të punës së personelit në nivel të shkollës.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve e këshillave profesionale.
- Shkathtësi në komunikimin elektronik, kompjuterik në aplikacione të programeve (Word, Excel, Pwer Point, Access etj).

Dokumentet e nevojshme:

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit);
- Diploma e kualifikimit të noterizuar;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmia e licencës së mësimdhënësit (vendimi dhe licenca), ose dëshmia që është në procedurë të licencimit,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,
- Portfolio profesionale (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA nr 08\2014)
- Letër-referencë nga një institucion publik kredibil si MASHT-i, DKA-ja, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak ose nga institucionet e arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuar për punën dhe angazhimin paraprak.
- Plani zhvillimor i institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 dhe me font të shkronjave Arial, madhësia 11, sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit.
- Dëshmia se kandidati nuk është nën hetim.

Mënyra e Aplikimit:

Formularët për aplikim merren në Drejtorinë e Arsimit dhe dorëzohen po në të njëjtën drejtori. Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Drejtorinë e Arsimit direkt ose përmes telefonit fiks 03820043727.

Konkursi mbyetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.

Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore - si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Arsimit

Nr. 12-3480 /2018
Klinë, 15/05/2018

Na osnovi clana 11, stav 1 Zakona Civilne Sluzbe Kosova broj 03/L-149 (Sluzbeni List Republike Kosova 72/2010), clana 34, stav 5 Zakona o Predunivestitskoj Obrazovanja 04/L-032, clana 5, tacka C Zakona Obrazovanja u Opstinama Republike Kosova 03/L-068, clana 2, tacka 2 AU br.08/2014 o postupcima I uslovima izabranja direktora edukativnih-obrazovnih institucija, Direktor Odeljenja Obrazovanja objavlja:

JAVNI KONKURS

za

Direktore edukativno-obrazovnih institucija kao sledece:

- NOŠŠ "Ismet raci, broj ref: JP00032983

Koeficientat plate: 7.8

Duznosti i odgovornosti:

- Rukovodjenje i administriranje skole,
- Priprema godisnjih planova rada i razvojnog plana skole,
- Sradjivanje sa savetom skole, profesionalim aktivimam i ostalim telima skola,
- Sacuvanje raznih dokumenata i podataka predvidjeno zakonom i ostalim normativnim dokumentima,
- Nadgeladavanje obrazovnih casova,
- Ocenivanja performanse nastavnika i ostalih radnika skole,;
- Planiranje i upravljanje budzetom skole;
- Sacuvanje finansiskoh dokumenata i davaje odgovornosti o troskovima,
- Ucesce u panelu za prijem skolskog kadra,
- Uzimanje odluka za osnivanje raznih komisija za interes skole,
- Ostale zadatke date od OOO u skladu sa vazecom normativom.

Broj referencije direktora NOŠŠ-ve: JP00029398

Za sve pozicije:

Nadzornik: Direktor Odeljenja za Obrazovanje
Radno Vreme: 40 sati
Rok Imenovanja: 4 godisnji mandat

Obavezno skolovanje:

- Minimum 4 godisnji universitetski nivo i uz 240 ECTS.
- Univezitetska diploma za nastavnike na osnovi upustva o licensiranju obrazovnog kadra.
- Regularna licenca za obrazovanje ili pri kraju licensiranja.

Iskustvo, sposobnosti i ostalo:

- Najmanje 3 godine iskustva u obrazovanju.
- Najmanje jedno od akreditiranih profesionalnih programa za upravljanje, administriranje ili rukovodjenje obrazovnim institucijama.
- Znanje o zakonima i regulativom oko obrazovanja kao i o skolskom i pedagogskom dokumentaciji učenika.
- Znanje o komuniciranju, planiranju i koordiniranu rada kadra skole.

Trazeni dokumenti:

- Licni dokumenti (izvod rođenja i kopija licne karte);
- Noterizovana diploma skolovanja;
- Dokaze o obukama akreditirane os MONT,
- Dokaz licensiranja kao nastavnik ili dokaz da licensiranje je u toku,
- Dokaz iskustva,
- Profesionalni portfolio (na osnovi upustva aneksa G AU br 08\2014)

- Referentno nismo od kredibilen javne institucije ud dokaz o prethodnom iskustvi i sposobnostima.
- Razvoji plan skolske institucije za koju konkurise (najamnje 10 stranice, razmak redova 1.5, slova Arial, velicina 11, po upustvima MONT),

Način konkurisanja:

Formulari za prijavu mogu se dobiti u Opštinskoj odeljenji obrazovanja i predaju se takodje u istoj odeljenji. Za detaljnije informacije možete kontaktirati odeljenje obrazovanja direktno ili preko telefona 03820043727.

Rok konkurisanja je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja. Nepotpunih dokumenati kao i oni predati posle roka neće se prihvatiti. Predati dokumenti se ne vraćaju.

Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republika Kosova i pozdravlja aplikacije muškog i ženskog pola kao i svih zajednica na Kosovu.

Direktor Odeljenja Obrazovanja
Arben Limanaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane “Prim.Dr.Daut Mustafa” Prizren



Nr./br. 8/8
Më/dana: 15.05.2018
Prizren

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07.2017, e protekular me Nr.371 të datës 19.10.2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në nenin 10, 18 dhe 20 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), në paragrafin 6 të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, kërkesës nr. 2/55, të datës 23.03.2018 të aprovuar nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së më datën 26.03.2018, si dhe nenit 13.1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS

Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar / Zeli da primi na posao na neodredjeno vreme

Titulli i pozitës/Naziv položaja:

1. Bachelor i radiologjisë/ Bachelor radiologije: 1 (një) pozitë / (jedna) pozicija

Kualifikimi i kërkuar për pozitën/ Kvalifikacija koja se zahteva za pozicije:

3. Diploma Bachelor i Radiologjisë dhe licenca e punës /Diploma bachelor radiologije i licenca rada.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju. Të ketë aftësi organizative në profesion/Da ima sposobnost organizacije na radu. Të njohë së paku një gjuhë vendore dhe është e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe puna me kompjuter/Znati najmanje jedan lokalni jezik i poželjno je znanje engleskog jezika i rad na kompjuteru

Paga/Plata: Paga mujore për këtë pozitë përcaktohet në bazë të rregullores së Ministrisë së Shërbimeve Publike/ Mjesečna plata za ovu poziciju se utvrđuje propisom Ministarstva Javnih Službi

Data e hapjes dhe data e mbylljes së konkursit / Datum otvaranja i datum zatvaranja konkursa: Prej/od 15.05.2018 deri/do 29.05.2018.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së publikimit / Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Paraqitja e kërkesave/ Podnošenje prijave

Aplikacioni-formulari merret në arkivën e spitalit /aplikacije-formular mogu se dobiti u arhivu bolnice. Kërkesat me saktësimin e pozitës duhet të paraqiten në kovertë të mbyllur deri më datën e fundit me të dhënat e plotë të aplikantit /Aplikacije, sa navedenim nazivom radnog mesta trebaju biti predate u zatvorenoj koverti sa punim podacima aplikanta do datuma zatvaranja konkursa sa potpunim informacijama aplikanta.

Dokumentat e kërkuara / Trazena dokumentacija:

- Diploma bachelor i radiologjisë me licencë / Diploma bachelor radiologije sa licencom.
- Certifikatën e lindjes / izvod rođenih;
- Certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime / izvod da niste osudjeni ili pod istragom;
- Certifikatën e mjekut / lekarsko uverenje;

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen/Aplikacije primljene nakon zatvaranja konkursa neće biti prihvacene.

Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Nekompletirane aplikacije mogu biti odbijene.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit, i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih pitanja.

Drejtor i Administratës
Ma. Sc. e Juridkut, Melinda Çollaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane “Prim.Dr.Daut Mustafa” Prizren



Nr./br. 8/9
Më/dana: 15.05.2018
Prizren

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07.2017, e protekular me Nr.371 të datës 19.10.2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Neni 10, 18 dhe 20 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), në Paragrafin 6 të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Nenit 13.1.1 të Statutit të Spitalit, si kërkesës nr.2/93 të datës 03.05.2018, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, Spitali i Përgjithshëm Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren shpall:

KONKURS

Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar / Zeli da primi na posao na neodredjeno vreme

Titulli i pozitës/Naziv položaja:

1. Mjek specialist- internist / lekar specialista- internist 1 (një)pozita / (jedna) pozicije

Kualifikimi i kërkuar për pozitën/ Kvalifikacija koja se zahteva za pozicije:

1. Arsimit universitar – diploma e Fakultetit të Mjekësisë, Licenca specialist internist / Universitetskog obrazovanje- diploma medicinskog fakulteta, Licenca specialist internista

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju. Të ketë aftësi organizative në profesion/Da ima sposobnost organizacije na radu. Të njohë së paku një gjuhë vendore dhe është e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe puna me kompjuter/Znati najmanje jedan lokalni jezik i poželjno je znanje engleskog jezika i rad na kompjuteru

Paga/Plata: Paga mujore për këtë pozitë përcaktohet në bazë të rregullores së Ministrisë së Shërbimeve Publike/ Mjesečna plata za ovu poziciju se utvrđuje propisom Ministarstva Javnih Službi

Data e hapjes dhe data e mbylljes së konkursit / Datum otvaranja i datum zatvaranja konkursa: Prej/od 15.05.2018 deri/do 29.05.2018.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së publikimit / Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Paraqitja e kërkesave/ Podnošenje prijave

Aplikacioni-formulari merret në arkivën e spitalit /aplikacije-formular mogu se dobiti u arhivu bolnice. Kërkesat me saktësimin e pozitës duhet të paraqiten në kovertë të mbyllur deri më datën e fundit me të dhënat e plotë të aplikantit /Aplikacije, sa navedenim nazivom radnog mesta trebaju biti predate u zatvorenoj koverti sa punim podacima aplikanta do datuma zatvaranja konkursa sa potpunim informacijama aplikanta.

Dokumentat e kërkuara / Trazena dokumentacija:

Diploma e Fakultetit të Mjekësisë, Licenca specialist internist / diploma medicinskog fakulteta, Licenca specialist internista.

Dokumentat tjera për të gjitha pozitën/Osyale dokumentacije za sve pozicije:

- Certifikatën e lindjes / izvod rođenih;
- Certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime / izvod da niste osudjeni ili pod istragom;
- Certifikatën e mjekut / lekarsko uverenje;

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen/Aplikacije primljene nakon zatvaranja konkursa neće biti prihvacene.

Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Nekompletirane aplikacije mogu biti odbijene.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit, i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih pitanja.

Drejtor i Administratës
Ma. Sc. e Juridkut, Melinda Çollaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitalit dhe Klinik Universitar i Kosovës
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane “Prim.Dr.Daut Mustafa” Prizren



Nr./br. 8/10
Më/dana: 15.05.2018
Prizren

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07.2017, e protekular me Nr.371 të datës 19.10.2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Neni 10, 18 dhe 20 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), në Paragrafin 6 të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Nenit 13.1.1 të Statutit të Spitalit, dhe Miratimit nga Ministria e Financave nr. 570, datës 05.05.2017, si dhe vendimit të Bordit Drejtues të SHSKUK-së, nr. 130/2 të datës 12.02.2018, Spitali i Përgjithshëm Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren shpall:

KONKURS

(Njësia e Dializës në Rahovec / Jedinica za dialize Orahovac)

Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar / Zeli da primi na posao na neodredjeno vreme

Titulli i pozitës/Naziv položaja:

1. Mjekë specialistë- internistë - rekomanduar nefrologë (në mungesë specializantë të nefrologjisë ose urologjisë) / lekar specialista- internista- preporučeni nefrolozi (u odsustvo specializant nefrologije ili urologije): 2 (dy)pozita / (dve) pozicije

Kualifikimi i kërkuar për pozitën/ Kvalifikacija koja se zahteva za pozicije:

1. Arsimit universitar – diploma e Fakultetit të Mjekësisë, Licenca specialist internist ose nefrolog/Universitetskog obrazovanje- diploma medicinskog fakulteta, Licenca specialista internista ili nefrologa

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju. Të ketë aftësi organizative në profesion/Da ima sposobnost organizacije na radu. Të njohë së paku një gjuhë vendore dhe është e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe puna me kompjuter/Znati najmanje jedan lokalni jezik i poželjno je znanje engleskog jezika i rad na kompjuteru

Paga/Plata: Paga mujore për këtë pozitë përcaktohet në bazë të rregullores së Ministrisë së Shërbimeve Publike/ Mjesečna plata za ovu poziciju se utvrđuje propisom Ministarstva Javnih Službi

Data e hapjes dhe data e mbylljes së konkursit / Datum otvaranja i datum zatvaranja konkursa: Prej/od 15.05.2018 deri/do 29.05.2018.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së publikimit / Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Paraqitja e kërkesave/ Podnošenje prijave

Aplikacioni-formulari merret në arkivën e spitalit /aplikacije-formular mogu se dobiti u arhivu bolnice. Kërkesat me saktësimin e pozitës duhet të paraqiten në kovertë të mbyllur deri më datën e fundit me të dhënat e plotë të aplikantit /Aplikacije, sa navedenim nazivom radnog mesta trebaju biti predate u zatvorenoj koverti sa punim podacima aplikanta do datuma zatvaranja konkursa sa potpunim informacijama aplikanta.

Dokumentat e kërkuara / Trazena dokumentacija:

Diploma e Fakultetit të Mjekësisë, Licenca specialist internist ose nefrolog (në mungesë të specialistëve për specializantë vendimi i specializimit) / diploma medicinskog fakulteta, Licenca specialista internista ili nefrologa (u odsustvo specialista za specializante resenje specializacije).

Dokumentat tjera për të gjitha pozitën/Osyale dokumentacije za sve pozicije:


- Certifikatën e lindjes / izvod rođenih;
- Certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime / izvod da niste osudjeni ili pod istragom;
- Certifikatën e mjekut / lekarsko uverenje;

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen/Aplikacije primljene nakon zatvaranja konkursa neće biti prihvacene.

Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Nekompletirane aplikacije mogu biti odbijene.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit, i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih pitanja.

Drejtor i Administratës
Ma. Sc. e Juridkut, Melinda Çollaku



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E ARSIMIT
UPRAVA ZA OBRAZOVANJE
DEPARTMENT OF EDUCATION

Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

DATA/DATUM/DATE	15.05.2018
NR/BR.	1151
PËR/ZA/TO	Publikimin e konkursit për pastrues
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Elabjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs

Në bazë të nenit 8 i Ligjit të Punës, nenit 37 paragrafi 2 dhe 4, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar, neni 5, pika c, të Ligjit për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS

Në shkollën e mesme të Mjekësisë “Elena Gjika” në Ferizaj, kërkohet:

-Një pastrues.

Detyrat e punës:

- Bëjë pastrimin dhe mirëmbajtjen e higjienës në institucionin shkollor.
- Kujdeset për pastrimin e të gjitha lokaleve shkollore, pajisjeve të shkollës si dhe objekteve përcjellëse.
- Kujdeset për pastrimin dhe mirëmbajtjen e oborrit të shkollës në mbrojtjen e ambientit dhe kultivimit të gjelbërimit.
- Kryen edhe detyra tjera, të cilat ia cakton drejtori i shkollës ose sekretari i shkollës.
- Për vendin e punës për pastrues kërkohet shkolla fillore e mesme e ulët.
- Kërkesa për aplikim merret dhe dorëzohet në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit.
- Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:
- Kërkesës për punësim duhet me ja bashkangjitur edhe dokumentacionin si vijon:
- Dëftesa e shkollës fillore të mesme të ulët,
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimi kopje,

Kontrata zgjatë një vit, nga data e fillimit të punës me mundësi vazhdimi. Puna provuese tre (3) muaj. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk merren në shqyrtim nga komisioni intervistues.

Afati i konkursit është (15) ditë, nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve, në web faqe e Komunitetit dhe në njërën nga mjetet e shkruar të informimit, duke filluar prej datës 15.05.2018, deri më 29.05.2018.

DA, Ferizaj



UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 Gjakovë, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831 E-mail: rektorati@uni-gjk.org
Web: www.uni-gjk.org

Nr. Prot.: 01/42
Datë 15/05/2018

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, Udhëzimit Administrativ 7/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe nenit 48 paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Senati UGJFA-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2018, mori vendim për të shpallur:

KONKURS

për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Gjakovës

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Programet: Edukimi Parashkollor dhe Edukimi Fillor

1. Një mësimdhënës për lëndët: Edukatë qytetare, Bazat e shkencave shoqërore me metodologji (programi parashkollor), dhe Histori kombëtare;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e arsimit muzikor me metodologji, Interpretimi me instrumente muzikore dhe Lojërat muzikore tradicionale.

II. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Programi: Gjuhë shqipe dhe letërsi

1. Një mësimdhënës për lëndët: Histori e letërsisë shqipe I, II dhe III dhe Letërsi arbëreshe;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Fonetikë dhe fonologji e shqipes së sotme, Morfologji I dhe II dhe Leksikologji e shqipes me semantikë;
3. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në teori të letërsisë, Letërsi popullore, Letërsi e sotme shqipe (poetia) dhe Letërsi e sotme shqipe (proza);
4. Një mësimdhënës për lëndët: Sintaksë e shqipes I dhe II, Histori e standardizimit të shqipes dhe Hyrje në gramatikë të tekstit të gjuhës shqipe.

Programi: Gjuhë dhe letërsi angleze

5. Një asistent për grup lëndësh nga Gjuha dhe letërsia angleze.

III. FAKULTETI I MJEKËSISË

Programet: Infermieri dhe Mami

1. Një asistent për grup lëndësh në Infermieri dhe Mami (Obstetrikë me Gjinekologji dhe Shëndeti riprodhues me Etikë, me plotësim norme nga lëndët e fushës së përafërt).

I. Kushtet e përgjithshme

1. Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së Nr. 01/160/1 të dt. 28.02.2018.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara me nenet 155, 156 dhe 157 të Statutit të Përkohshëm të UGJFA-së, dhe atë:
 - të kenë gradën e doktorit të shkencës;
 - të kenë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore, konform neneve përkatëse;
 - të tregojnë aftësi për mësimdhënie;
 - të kenë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet;
 - të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse.
3. Kandidatët që aplikojnë për asistent duhet të plotësojnë kushtet e parapara me nenin 159, paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Përkohshëm të UGJFA-së, dhe atë:
 - të kenë të përfunduar me sukses studimet master në drejtimin përkatës;
 - të jenë jo më të vjetër se 30 vjet kur emërohen për herë të parë;
 - të kenë të regjistruar studimet e doktoratës me rastin e rizgjedhjes;
 - të kenë notën mesatare jo me pak se 8 në studimet baçelor dhe në ato master.

II. Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a. kërkesën për aplikim;
 - b. një CV (biografi) profesionale;
 - c. certifikatën e lindjes (origjinale) dhe kopjen e letërnjoftimit;
 - d. kopjen e diplomës përkatëse (për pozitën e mësimdhënësit diploma e tri niveleve të studimeve, ndërsa për pozitën e asistentit diploma për dy nivelet e studimit dhe pasqyrën e notave) të vërtetuara nga noteri;
 - e. kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë). Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim.
 - f. dëshmitë për monografite dhe publikimet shkencore e profesionale në revista ndërkombëtare shkencore brenda kornizës së përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.01/2018 dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së Nr. 01/160/1 të dt. 28.02.2018;

- g. kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UGJFA, duhet të sjellin dëshmi nga organet kompetente që nuk janë në hetime ose nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale (origjinale);
- h. dëshmi mbi përvojën e punës në mësimdhënie;
- i. si dhe informata tjera shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

III. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës.
2. Kriteri i moshës i përcaktuar në nenin 159 të Statutit vlen për kandidatët të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e përmbylljes së konkursit. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin e Gjakovës në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 159 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
3. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

IV. Vendimi, perioda e ankimit dhe e përmbylljes së konkursit

1. Kandidatët të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve kompetente të njësive akademike, përkatësisht Senatit të UGJFA-së, gjatë procesit të përzgjedhjes së personelit akademik, kanë të drejtë ankese në dy faza:
 - a) Faza e parë e ankimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të Buletinit në ueb-faqe të UGJFA-së. Buletini do të qëndrojë i publikuar 15 ditë në ueb-faqe të UGJFA-së. Ankesa duhet të dorëzohet në njësinë akademike përkatëse dhe do të shqyrtohet nga këshilli i njësive akademike brenda 15 ditësh nga dita e përmbylljes së afatit të ankimit. Raporti përfundimtar pas shqyrtimit të ankesave i dërgohet për njoftim Komisionit të Studimeve lidhur me rregullsinë e procedurës dhe propozimeve nga fakultetet.
 - b) Faza e dytë e ankimit bëhet ndaj vendimit të Senatit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit në dorëzim të vendimit. Ankesa duhet të drejtohet Komisionit të Senatit për ankese dhe parashitje, që shërben si instancë e fundit e ankimit në UGJFA. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i ankesave i prezantohet Senatit për vendosje përfundimtare në nivel të UGJFA-së. Propozimi i Komisionit të Senatit për ankese dhe parashitje nuk ka karakter obligativ për Senat.
2. Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin përfundimtar të Senatit.
3. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UGJFA-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
4. Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimum për 30 ditë.

V. Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë fizike dhe elektronike (CD).
2. Dokumentacioni në formë fizike dhe elektronike (CD) duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, përkatësisht për:
 - Fakultetin e Edukimit në adresën "Normalja e Gjakovës" pn., 50000 Gjakovë;
 - Fakultetin Filologjik në adresën "Normalja e Gjakovës" pn., 50000 Gjakovë;
 - Fakultetin e Mjekësisë në adresën "Mithat Frashëri" pn., 50000 Gjakovë.
3. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tersi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen edhe në formë elektronike (me CD), nuk do të merren në shqyrtim.
